



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:
“Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente”
Universiteti “Barleti”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Klodiana GORICA

Dr. Nevila ÇINAJ

Korrik / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Bachelor në "Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente"

1	IAL aplikues:	Universiteti "Barleti"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në "Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 462, datë 27.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	19 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 4 studentë; 2020-2021 8 studentë; 2021-2022 3 studentë;
19	Komente / të tjera:	-


TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi Bachelor në "Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente" është licensuar me Urdher MASR Nr. 462, date 27 Korrik 2018. Sipas dokumentit të hapjes me UMASR Nr. 462, date 27.07.2018, programi fillon veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019.

Programi Bsc në "Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente" ofrohet nga Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit DMTR, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve (FShSTS).

Ky program në vitin e parë të lancimit të tij, 2018-2019 është ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, Departamenti Bisnes, Menaxhim dhe Turizëm, dhe në vijim ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve, Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit. Sipas VKM nr 41, dt 21.01.2018 ku programi studimi është i organizuar sipas veprimtarive formuese të klasifikuara "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL dhe VKM nr 185, dt 25.03.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, dt 22.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", i ndryshuar".

Aktualisht ky program është në vitin e katërt të ofrimit të tij si aktivitet mësimor dhe kërkimor. Programi synon të kontribuojë në rritjen e standardeve të turizmit, demokracisë dhe qyteterimit të shoqërisë shqiptare dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë. Programi synon të kontribuojë në përmirësimin e standardeve, të cilësive dhe rritjen e vlerës së shtuar në shërbimet që ofrohen në industrinë e turizmit, rekreacionit dhe eventeve. Është bazuar dhe mbështetur në Strategjinë Kombëtare të zhvillimit të Turizmit të Qendrueshëm 2019-2022. Misioni i këtij programi të studimit është hartuar në përputhje me misionin e institucionit për të përgatitur studente me aftësi krijuese, menaxheriale dhe teknike. Programi e reflekton misionin dhe vizionin e institucionit, të shprehur në statutin e tij të 2005 që ka qenë në fuqi në momentin e aplikimit të programit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente” të ofruar nga Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit pranë Universitetit “Barleti”, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.


ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UniBa, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Klodiana Gorica dhe Dr. Nevila Çinaj. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Vizita në Universitetin “Barleti”, u realizua në datën 24/03/2022, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL.

Gjatë vizitës, në Universitetin “Barleti”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësën e Departamentit të Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit dhe Dekanin e FSHSTS, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së planifikimit të karrierës dhe Studentëve të diplomuar, si dhe me sekretarinë mësimore. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Universiteti “Barleti” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.06.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 20/62 Prot, datë 01.07.2022. Universiteti “Barleti” përcjell në ASCAL më datë 30.06.2022, me anë të shkresës me Nr. 851 Prot, datë 28.06.2022, “Kthim përgjigje” ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Menaxhim në Turizem, Rekreacion dhe Evente”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE


Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Ne dokumentat strategjike theksohet rëndësia e këtij institucioni të arsimit të lartë në raport me qasjen ndaj inovacionit dhe sipërmarrjes, duke e kthyer atë në një universitet aplikativ, me një qasje shumë më të madhe drejt tregut dhe nevojave të tij, dhe rrjedhimisht në mbështetje të interesave kombëtare. <i>Dok 3. Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030</i> <i>Dok 2. Statuti Marlin Barleti</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi ndërtohet edhe në mbështetje të Strategjisë kombëtare për zhvillimin e turizmit si dhe në mbështetje të Ligjit të arsimit të lartë shqiptar. Në pari synon të rrisë në nivele kombëtare profesionalizmin dhe standartizojë shërbimet në turizmin shqiptar dhe në dyti synon të forcojë vlerat akademike kombëtare. <i>Dok 54. Strategjia kombëtare e zhvillimit të qendrueshëm të turizmit 2019 – 2023, qëllimi strategjik, fq 3.</i> <i>Dok 53 Ligji arsimit të lartë, nr 80/2015</i>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2023 konfirmon thekson të rëndësishëm në politikën e këtij IAL formimin multidiplinor dhe aftësitë soft. Aty theksohet se UniBa do të jetë një universitet aplikativ, inovator dhe krijues. Misioni dhe vizioni i shprehur në këtë strategji tregojnë qartë qasjen me zhvillimin e vendit dhe të sektoreve më të rëndësishëm të tij si dhe qasjen e një universiteti aplikativ të fokusuar fort sa në shkencë aq edhe në inovacion dhe sipërmarrje. Nderkohe që ky program studimi është hapur në vitin akademik 2018-2019 dhe strategjia e zhvillimit institucional i përket periudhës 2020-2030. <i>Dok 3. Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030</i>
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi i shërben formimit të profesionistëve të fushës së turizmit të konsideruar si një ndër sektorët më të rëndësishëm të vendit tonë. Përmes ofrimit të diplomës në “Turizem, rekreacion dhe Evente”, ky program synon të furnizojë tregun me menaxherë të këtij sektori duke i shërbyer

	<p>direkt rritjes se formimit profesional, njohurive dhe permiresimit te cilesise se sherbimit per kete sektor, dhe rrjedhimisht edhe rritjes dhe zhvillimit ekonomik dhe social te vendit. Programi i studimit eshte ne perputhje me konteksin, misionin dhe vizionin e strategjise se ketij institucioni si dhe me shtyllen e zhvillimit te Universitetit Barleti te percaktuar ne kete dokument.</p> <p><i>Dok 3. Strategjia e zhvillimit institucional 2020 2030</i> <i>Dok 2. Statuti Marlin Barleti</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2023 konfirmon dhe thekson te rendesishem ne politikat e ketij IAL sfidat e profesionisteve te se ardhmes (fq 10). Aty theksohet se UniBa do te jete nje universitet aplikativ, inovator dhe krijues. Gjithashtu nje theks i vecante ne kete dokument strategjik i vihet edhe nderveprimi me industrine ne kuader te universiteti aplikativ. (fq12). Misioni dhe vizioni i shprehur ne kete strategji tregojne qarte qasjen me zhvillimin profesional nderkohe qe ky program studimi eshte hapur ne vitin akademi 2018-2019 dhe strategjia e zhvillimit institucional i perket periudhes 2020-2030. (<i>Dok 3. Strategjia e zhvillimit institucional 2020 2030, fq 9, 10, 12</i>)
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statusi i Universitetit Marlin Barleti 2020, dhe Rregullorja e Institucionit e miratuar me vendim te Senatit Akademik nr 60, date 13/04/2021, percaktojne ne objektivat, parimet dhe shtyllat e aktiviteteve kryesore te UniBa, drejtimit prioritar akademike dhe demostrojne qarte se programet e studimit hartohen ne zbatim te tyre, ne funksion te pasjes se nje universiteti novativ dhe sipermarres. Per kete statusi percakton njesite te cilat kujdesen per mbarevajtjen e programeve. Pervec fakulteteve dhe departamenteve perkatese ka krijuar dhe njesite qe kontrollojne cilesine apo matin performancen. <i>Dok 5. Rregullore e Universiteti Marlin Barleti, neni 12, 13, 14, 15.</i> <i>Dok 2, Statuti, neni 3, 5, 6</i>

<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve, Departamenti Turizmit Mikpritjes dhe Rekreacionit. Emertimi, struktura dhe organizimi i programit të studimit bazohet dhe është ndertuar mbi fushat e drejtimit akademik dhe të kërkim zhvillimit të UniBa. Sipas RVB thuhet se bazuar në Strategji e zhvillimit institucional 2020 2023, faqe 10, zhvillohet në përputhje ky program studimi. Po në këtë strategji thuhet se janë zhvilluar analiza të herëpërhershme të tregut të punës që konfirmojnë dhe mbështesin këtë strategji për kohën e aplikimit të saj (pas 2020).</p> <p><i>Dok 3. Strategjia e zhvillimit institucional 2020 2023, faqe 10, 11</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Program i studimit synon të pajisë studentet me një formim akademik baze të përqendruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për t'i përdorur në karrierën profesionale në sektorin e turizmit si dhe në aftësimin për t'i përballur kërkesat e tregut të punës në sektorin përkatës. Plani strategjik i zhvillimit të programit tregon qartë se departamenti koncepton që në nisje një përpjekje çilesore në shërbim të ofrimit të një kurrikule çilesore, dinamike dhe sfiduese. P.sh, përpjekja për të ofruar një diplomë të tillë, me këtë emërtim dhe jo thjesht emërtim në manaxhim turizem është një përpjekje për të ofruar dicka ndryshe nga ajo cka ofrohet nga institucione të tjera, dicka me inovative e cila kërkon nderkohe pa diskutim përmirësime të vazhdueshme. Plani strategjik përcakton dhe një analizë SWOT të këtij programi studimi duke vërejtur identifikuar vështirësitë dhe sfidat në rrugetimin e krijimit të këtij. Po në këtë plan përfshihen edhe aftësitë, dijet dhe kompetencat të cilat shprehen përmes realizimit të objektivave që karakterizojnë profilin e programit.</p> <p><i>Dok 4. Plani Strategjik i zhvillimit të programit</i></p> <p><i>Dok 7: Rregullore e programit Bachelor Manaxhim Turizem, Rekreacion dhe Evente, neni 2, 3 fq 3.</i></p>



<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Sikurse tregohet edhe në faqet e para të planit strategjik të zhvillimit të programit, ky program studimi u bazua në një perceptim në rritje të nevojës për të patur manaxhere në turizem, rekreacion dhe evente, dhe për të patur me shumë specialist në fushën e manaxhimit të turizmit, rekreacionit dhe eventeve. Është vënë në dispozicion të GVJ <i>dokumenti nr 16</i>, që synon të përgjithësojë një studim tregu të punës përpara hapjes së programit. Ky dokument është i pamjaftueshëm për t/u konsideruar studim i mirefillte tregut, presupohet t'u jetë dërguar 114 institucione dhe 85 prej tyre të jenë përgjigjur. <i>GVJ sugjeron që departamenti që ofron këtë program studimi të ndermarre një studim cilesor dhe sasior të tregut, të detajuar ku të jepet të gjitha analizat, statistikën, rezultatet dhe konsiderimet e rezultuara, mbi bazën e se ciles do të mund të përmiresohet apo ndërtohet një kurrikul me cilesore të këtij program.</i></p> <p>Në këtë mënyrë, departamenti DMTR vertet do të realizojë një studim tregu, do të mundet “të bashkojë” një kurrikul të bashkuar me biznesin, dhe të ofrojë atë çka kërkon biznesi, me qëllim që të rrisë jo vetëm numrin e studentëve që frekuentojnë këtë program studimi por edhe të rrisë punësimet e tyre sipas profilit të diplomës. Gjithashtu, ky program studimi ka nevojë të kryejë në mënyrë paralele edhe studime pas diplomimit të studentëve që të përcaktojnë se sa kanë përfituar diplomimet e tyre me pritshmeritë e tregut të punës. Pavarësisht se tregu i turizmit është treg dinamik që evoluon dhe kërkon gjithnjë përmirësimin e cilësive të shërbimeve, ofrimi i një diplome cilesore do të rrisë standartin e sektorit turistik shqiptar.</p> <p>Dok 4. Plani Strategjik i zhvillimit të programit</p> <p>Dok 16. Studimi i tregut të punës përpara hapjes së programit “Manaxhim në turizem, Rekreacion dhe Evente”</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të nxënies, garantojnë përfundimin e dijes, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Përmes dokumentave strategjike të paraqitura në këtë program studimi bëhet një përpjekje për të koordinuar nevojën që ka tregu me objektivat që ky program studimi vendos. Kjo reflektohet në analizat vjetore dhe periodike të departamentit, në vlerësimin dhe mendimin e dekanit të fakultetit për hapjen e këtij program studimi, në rregulloren e programit të studimit apo në dokumenta të tjera. Plotësimi i këtyre objektiveve, sikurse u diskutua edhe përgjatë vizitës në institucion do të mundësohet të jetë shumë në përputhje me kompetencat dhe aftësitë e kërkuara që vertet do të kërkojnë studimet e ardhshme të tregut. Pra, nevoja e studimeve të mirefillta shkencore, të ndermarra posaçërisht për përmirësimet e këtij program studimi, apo edhe studimet pas diplomimit, jo vetëm</p>

	<p>qe do te perafrojne perqasjen e ketyre aftesive dhe kompetencave por do te garantojne edhe nje diplomim cilesor dhe sipas profilit te diplomes. Si pjese e tabelave permbledhese ne dokumentin <i>C Aneks</i>, eshte vene ne dispozicion <i>tabela 23</i> qe reflekton cilesine ne hyrje dhe ne dalje te studenteve. Sipas kesaj tabele, per vitin 2018-2021 rezulton se:</p> <p>a. Numri total i te regjistruarve eshte relativisht i ulet per te treja vitet e studimit, madje edhe me i ulet eshte per 2021 2022;</p> <p>b. Numri i te diplomuarve total eshte 3 studente, dhe ato te punesuar ne perputhje me diplomen eshte vetem 1, pra pak e atyre qe jane regjistruar ne kete program studimi punesohen sipas tregut qe kane bere programin e studimit;</p> <p>Ky perben nje tregues se marreveshjet e bashkepunimit jane jo efektive. Persa kohe qe numri ne hyrje eshte relativisht mjaft i ulet, por edhe me i ulet eshte numri i te diplomuarve dhe vecanerisht i atyre te punesuar ne tregun aktual te punes qe orienton programi ne fjale, kjo tregon se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ose nuk eshte ndertuar mire programi, dhe njohurite e marra nuk perafrojne me tregun; - Ose nuk jane eficente marreveshjet e bashkepunimit; <p><i>Dok 29 a Lista e studenteve te diplomuar qe jane punesuar</i> <i>Dok aneks 29, tabela 23 Te dhëna per diplomimin dhe punesimin e studenteve (tab 23)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	UniBa perben nje institucion te arsimit te larte te mireorganizuar permes institutive dhe njesive qe e kontrollojne cilesine dhe vleresojne performancen. Eshte e padiskutueshme se prania e institutive kerkimore brenda UniBa do te ndikojte edhe ne permiresimin dhe rritjen e kapaciteteve njesore edhe per kete program studimi ne te ardhmen.



	<p>Programi ofrohet nga Departamenti i Mikpritjes Turizmit dhe Rekreacionit të Fakultetit të Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit.</p> <p>Ky Fakultet për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 89 pedagogë, nga të cilët 42 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 4 kanë titullin “Profesorë”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 13 kanë gradën Dr, dhe 22 Asistent Lektorë me Msc; dhe 47 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 5 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 19 kanë gradën Dr. dhe 23 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Mikpritjes Turizmit dhe Rekreacionit ka gjithsej 10 pedagoge nga të cilët 8 janë pedagoge efektiv (PAE), nga ku: 1 ka titulli “Profesor i Asociuar”, 3 kanë gradën Dr, dhe 4 Asistent Lektorë me Msc; dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka gradën Dr. dhe 1 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p><i>Doc.1.Stafi i Fakultetit, Departamentit dhe të angazhuar në program</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti DMTRE, pranë Fakultetit të Shkencave sociale turizmit dhe sporteve. Kalimi i ofrimit të këtij programi nga Fakulteti Ekonomise në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve e rrit rëndesinë e tij për shkak se edhe departamenti dhe fakulteti kanë lidhje direkte me turizmin dhe i dedikohen atij, plus përben një këndvështrim me të gjere, edhe në kontekstin social të tij. Megjithatë, fakti që është jashtë fakultetit të ekonomise dhe sipërmarrjes, përben një çështje për t’u diskutuar në të ardhmen. Ky program studimi është hartuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), dhe është i regjistruar si program i ciklit të parë bachelor, niveli 6 i Kornizës Kombëtare të kualifikimeve dhe përfshirë në fushën kryesore “Shkenca Sociale” ku fushat e studimit janë: turizmi, rekreacioni dhe eventet. Në përfundim të këtij program studimi leshohet Diplome për ciklin e parë Bachelor.</p> <p><i>Dok 55, VKM nr 41, date 24.01.2018, Shtojca 1</i></p> <p><i>Dok 57, VKM nr 185 dt 25.03.2021, Shtojca 1</i></p> <p><i>Aneksi 29 Tabelat përmbledhese</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e</p>	<p>Në fillimet e lancimit të këtij program studimi ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i shkencave të aplikuara dhe ekonomise, Departamenti Bisnes Manaxhim dhe Turizem. Pra ishte Departamenti Bisnes, Manaxhim dhe Turizem përgjegjës për programin bachelor në Manaxhim në Turizem, Rekreacion</p>

<p>kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>dhe Evente. Ne vitet e metejshme, 2019 2020, 2020 2021, dhe 2021 2022, ky program studimi ofrohet nga Departmenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve. Turizmi në vetvete përben një fushë ndërdisiplinore, program i se ciles e konfirmon kete. P.sh. prania e lendeve ekonomike si mikro dhe makro, apo drjetimi financiar qe i perkasin departamenteve ekonomike, por edhe nevoja e ketij programi per te patur nje qasje edhe ndaj departamentit apo fakultetit te ekonomise, përben pa diskutim një nevojë për të shqyrtuar në të ardhmen pozicionimin e tij.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Ky program studimi është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018 2019, me synimin për të patur një qasje me profesionale ndaj tregut. Ashtu sikurse u konstatua edhe nga vizita në terren, brenda institucionit ka patur një mbështetje positive për të hapur këtë program studimi dhe për t'ua bërë atë të suksesshem. Për këtë janë angazhuar jo vetëm departamenti i DMTRE si përgjegjës për këtë program studimi por edhe njesite e tjera qofte përgjegjese për cilesine, karrieren apo etiken. DMTRE ka hartuar rregulloren dhe mban në mënyrë periodike mbledhjet për mbarevajtjen e ketij program studimi. Përveç përgjegjesit të departamentit janë ngritur edhe shume njesi të tjera si kordinatori i programit, bordi i karrieres, dekani i studenteve, zura e karrieres, etj.</p> <p><i>Dok 4. Plani Strategjik i zhvillimit të programit</i></p> <p><i>Dok 7: Rregullore e programit Bachelor Manaxhim Turizem, Rekreacion dhe Evente, neni 2, 3 fq 3.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie</p>	<p>Institucioni ka një qasje të hapur ndaj biznesit lokal dhe kombëtar dhe synon të mbështesë atë përmes qasjes së vet inovative dhe sipërmarrëse. Tashmë kjo është e reflektuar në të gjitha dokumentat e veta strategjike. Institucioni në nivele</p>


<p>bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>makro ka vendosur shume marreveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme brenda dhe jashte vendit. E reflektuar edhe ne dokumentat kryesore te UniBA, si statuti, rregullorja apo strategjia e zhvillimit instiucional reflektohet nevoja dhe qasja ndaj biznesit per te synuar dhe arritur orientimin drejt inovacionit. Njesia pergjegjese per kete program studimi, Departamenti i Turizmit rekreacionit dhe eventeve ka hartuar per 2020 2021 nje raport per efektivitetin e marreveshjeve te bashkepunimit. Ne <i>tab 34</i>, Marreveshje Bashkepunimi aktive, tregohen disa marreveshje bashkepunimi te vendosura midis institucionit dhe institucioneve te tjera jo akademike brenda vendit, si Hotel Adriatik, Kastrati, Sky Tour, etj. Keto marreveshje jane vendosur ne muajin korrik 2021 dhe jane aktive per pas kesaj periudhe, nderkohe qe ky program studimi ka filluar ne 2018 2019 e me tej per 2 vite te tjera akademike.</p> <p><i>Dok 32 Tabele perbledhese me institucionet bashkepunuese, per programin e studimit dhe praktiken profesionale.</i></p> <p><i>Dok 34 Marreveshje Bashkepunimi Aktive</i></p> <p><i>Dok 35 Raporti periodic analitik I perfitimit nga marreveshjet e bashkepunimit per vitin akademik 2020 2021</i></p> <p><i>Dok 35. Raporti i perfitimit nga marreveshjet e bashkepunimit MTRE, 2020 2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Marreveshjet e bashkepunimit dhe efektiviteti i tyre behen te dukshme ne rradhe te pare ne procesin e realizimit te praktikave mesimore. Normalisht ky program studimi permban kredite dhe ore te praktikës mesimore, te shperndara. Kjo do te thote se institucionet bashkepunuese luajne nje rol kyc ne perftimin e njohurive praktike, gje e cila ne fakt nuk orientohet mire.</p> <p><i>GVJ rekomandon qe te orientohen te gjitha marreveshjet drejt institucioneve publike dhe private, dhe se dyti drejt atyre qe kane lidhje me turizmin dhe perbejne potenciale punesimi me tej.</i></p> <p>Nderkohe qe, e konsideruar shume e rendesishme ne formimin e studenteve dhe transmetimin efektiv te njohurive, praktika duhet te zhvillohet ne ato institucione ku vertet kane nevojë per njohuri profesionale te turizmit, manaxhimit te eventeve apo elementeve te rekreacionit, pra te organizohet ne ministri apo autoritete publike te turizmit, apo siper marrje te mirefillta te turizmit. Nje studim i mirefillte i tregut do te nxirrte dhe rezultonte nevojën se vertet ka nevojë per specialist te tille bachelor apo master dhe jo te programeve te formimit profesional.</p>

	<p><i>Dok 32 Tabele permbledhese me institucionet bashkepunuese, per programin e studimit dhe praktiken profesionale.</i></p> <p><i>Dok 34 Marreveshje Bashkepunimi Aktive</i></p> <p><i>Dok 35 Raporti periodic analitik I perfitimit nga marreveshjet e bashkepunimit per vitin akademik 2020 2021</i></p> <p><i>Dok 35. Raporti i perfitimit nga marreveshjet e bashkepunimit MTRE, 2020 2021</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni vendos marrëdhënie me organizatat kombetare dhe lokale për kryerjen e praktikës. Kjo vihet re nga një numër i konsiderueshëm i marrëveshjeve të bashkëpunimit që ky institucion ka vendosur. Në lidhje me institucionet bashkëpunuese në rang program studimi në tab 5, fq 5 tek anekset me tabela, vihet re se vetëm Mondial dhe Sondor Travel Albania janë institucione që i përputhen këtij programi, pjesa tjetër janë 1 bashkia mat, 2 institucione në Durres dhe agjensia komb e turizmit.</p> <p><i>Sugjerohet një qasje edhe ndaj institucioneve publike të turizmit në vendin tonë si dhe një qasje më e madhe ndaj kompanive që marrin dhe investojnë direkt në turizmi shqiptar.</i></p> <p><i>Dok 34. Marreveshje bashkepunimi active DMTR</i></p> <p><i>Dok 35. Raporti i perfitimit nga marreveshjet e bashkepunimit MTRE, 2020 2021</i></p> <p><i>C. Anekset me Tabela, tab 5, fq 5</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>UniBa ofron edhe kurse të formimit profesional duke u dhënë studenteve mundësi edhe të licensimit dhe aftësisht profesional të certifikuar. Kështu, UniBa është e licensuar dhe ofron trajnime për: Udhërfyes turistik Kombëtar, ndërkohë që kjo rrit mundësi e punësimit të studenteve me tej.</p> <p><i>Dok 59, Shkrese nga MASR për akreditimin e programit Udhërfyes Turistik Kombëtar, date 28.12.2018</i></p> <p><i>Dok 33. Tabele permbledhese për trainimet për studentet e diplomuar për vitin akademik 2020-2021</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ky program studimi është hartuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mesimor është i ndarë në 3 vite akademike, dhe 6 semestra, në lende dhe module të vlerësuara me kredite. <i>Sugjerohet një rishpërndarje e krediteve sipas rëndësisë së lendeve e reflektuar kjo edhe me një rishpërndarje të orëve në leksione dhe seminare.</i> Keshtu p.sh. vihet re se të gjitha lendet kanë 6 kredite, ndërsa ka pak lende me të njëjten ngarkesë orësh në leksione dhe seminare që kanë 3 kredite.</p> <p><i>Dok 14 B Plani Mesimor për programin e studimit MTRE ndarë sipas veprimtarive</i></p> <p><i>Dok 14 A Plani Mesimor për programin e studimit MTRE</i></p> <p><i>Aneksi 29 Tabelat përmbledhese</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Ky program studimi përben një përpjekje për të furnizuar studentet me aftësi njohëse dhe praktike gjithpërfshirëse, kjo është dokumentuar edhe në diskutimet me grupin e stafit të pedagogëve. Por kjo nuk mohon faktin se zhvillimi dhe përfundimi i kompetencave lidhet fort edhe me tregues të tjerë cilësor dhe sasior të cilët mungojnë apo duhet të jenë objekt i rishikimit të mëtejshëm në përmirësimet e ardhme të kurrikules. Këto çështje, të përmbledhura me poshtë, u diskutuan si me drejtuesit e fakultetit, njësisë baze që e ofron këtë program studimi, po ashtu edhe u përmbledhën në takimin e fundit gjatë vizitës në institucion.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aftësimi me njohuri aftësi dhe kompetenca profesionale kërkon me shumë lende praktike, dhe jo lende të formimit baze. Shumë lende si Parimet e mikroekonomisë, makroekonomia, drejtimi financiar, etj, të sillen përmes rasteve apo ndonjë kapitulli në formën e tilla që të reflektohen njohuri të tyre për turizmin; 2. Emertimet e lendeve të jenë sa më të thjeshta dhe të reflektojnë njohuri që transmetojnë; 3. Përmbajtja e syllabuseve të thjeshtohet dhe freskohet me literaturë koherente si dhe materiale në gjuhën shqipe. Po




	<p>keshtu literaturat e sugjeruara jane mjaft te vjetra, nuk jane me te mirat ne treg, dhe kerkojne nje perditesim dhe reflektim te hollesishem i tegut vendas dhe me tej me literature te huaj;</p> <p>4. Lende si anglishtja apo teknologji e informacionit te sillen totalisht per turizmin duke u kthyer ne anglishtja per turizmin, sistemet e informacionit ne turizem;</p> <p>Perplasja e koncepteve midis lendeve te ndryshme krijon konfuzion dhe pasiguri ne marrjen e njohurive dhe rrjedhimisht te kompetencave kyce. <i>Doc 19 Syllabuset e lendeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Trajtimi i ketij programi me tre kompetenca kyce: turizem, rekreacion dhe evente kerkon pa diskutim nje shperndarje te perftimitt e marrjes se njohurive permes 3 grupeve te lendeve qe duhet te ndahen ne keto drejtime. Pra qe ne fillim presuposohet qe te kete nje “minigrupim” ne 3 kategori te lendeve: ata qe japin njohuri per turizmin, ata qe japin njohuri per rekreacionin, dhe ata qe japin njohuri per eventet. Pasi e tille eshte filozofia e ndertimit te kesaj kurrikule, te mbuloje nje fushe te gjere te kompetencave dhe aftesive ne vend te njerës, psh manaxhim ne turizem. Nga ana tjetër, ky program studimi eshte program manaxhimi por i cili varet nga nje fakultet i shkencave sociale (pra jo ekonomike), dhe e gjitha ka ne brendesi edhe nevojën per te ofruar lende baze te formatit: Manaxhimi Turizmit, Manaxhimi Turizmit te qendrueshem, Marketingu Turizmit, etj. Lende te tilla manaxheriale do te mbulojne nevojën qe ka kjo qasje e ketij bachelori ne Manaxhim Turizem, Rekreacion dhe Evente, dhe per me teper qe ky program studimi eshte konsultuar me Strategjine Kombetare te Zhvillimit te Turizmit Qendrueshem Shqiptar 2019 2023.</p> <p><i>Dok 14 B Plani Mesimor per programin e studimit MTRE ndare sipas veprimtarive</i></p> <p><i>Dok 14 A Plani Mesimor per programin e studimit MTRE</i></p> <p><i>Aneksi 29 Tabelat permbledhese</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet ne 3 vite akademike, 6 semestra dhe ne perputhje me Nivelin 6 te Kornizes Kombetare te Kualifikimeve. Permban elementet qe perbejne strukturen e plote te programit te studimit. Programi i studimit Bachelor në “Manaxhim Turizem Rekreacion dhe Evente”, përmban një informacion në fushën e turizmit, eventeve dhe rekreacionit. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive në fushat specifike dhe të specializuara që ky program i ciklit të parë të studimeve ofron si dhe në përftimin e aftësive</p>

	<p>profesionale dhe kompetencave për t'i shërbyer më mirë tregut të punës. Por konsiderohet qe ky informacion duhet te jete me i plote dhe i shperndare ne menyre te njetrajtshme midis te tre komponenteve qe merr persiper te plotesoje: turizmi, eventet dhe rekreacioni. Per kete arsye, <u>GVJ sugjeron qe ne te ardhmen te mundohet te behet nje shperndarje sasiore dhe cilesore (ne brendesi te syllabuseve) te koncepteve qe lidhen me te tri fushat.</u></p> <p>Dok 53, Ligji arsimit te larte nr 80/2015 Dok 55, VKM 41, dt 24.01.2018</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Sipas planit mesimor te ndare sipas aktiviteteve, brenda programit MTRE jane te ndara veprimtarite formuese sipas percaktimeve te akteve ligjore dhe nenligjore ne lende baze, karakterizuese, nderdisiplinore, plotesuese dhe detyrime permbyllese.</p> <p>Lendet jane te grupuara si me poshte:</p> <p>A. Lende baze – 6 lende 36 kredite = 20%; B. Lende karakterizuese 18 lende, 96 kredite = 53.3%; C. Lende nderdisiplinore/integruese 4 lende, 18 kredite = 10%; D. Lende plotesuese 3 lende, 18 kredite = 10%; E. Detyrimet permbyllese 1 lende, 6 kredite = 3.3%;</p> <p>Jane dhene sugjerimet perkatese per nje riorganizim te lendeve ne terma te formulimit te tyre, te permbajtjes dhe syllabuseve perkatese me qellim qe te sigurohet transmetimi i dijeve aftesive dhe kompetencave te duhura.</p> <p><i>Pas diskutimit edhe ne institucion me stafin dhe drejtuesin e departamentit, gjykohet qe te behet nje rishperndarje sipas 3 ose 4 grup moduleve: moduli i turizmit, moduli i rekreacionit, dhe moduli i eventeve, duke synuar ofrimin e njohurive te plota teorike dhe aftesimet praktike ne te tre dejtmet, dhe duke patur parasysht plotesimin edhe me lende manaxheriale.</i></p> <p>Dok 14 B Plani Mesimor per programin e studimit MTRE ndare sipas veprimtarive formuese Dok 14 A Plani Mesimor per programin e studimit MTRE</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi është me kohë të plotë dhe realizohet në 3 vite akademike të ndarë në 6 semestra, me nga 15 javë secili të cilat ndahen në lëndë/module bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” e ndryshuar dhe rregulloren e programit të studimit. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, i përmbush detyrimet ligjore për akreditimin e programit, ne vitin 2020 – 2021 perbehet nga 8 anetare si pjese e stafit me kohe te plote, 2 prej te cileve jane me titull prof asoc, 1 ka graden doktor dhe 5 jane me Master Shkencave. GVJ referuar informacionit në sistemin e informacionit të ASCAL, konstaton se Universiteti Barleti është akredituar për herë të parë si institucion sipas Urdhrit Nr. 288, datë 04.09.2009, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 60, datë 16.12.2021, të Bordit të Akreditimit me kohezgjatje 5 vite akademike, dhe vlefshmeri deri me 15.12.2026. Programi Bsc në MTRE, po akreditohet per here te pare.</p> <p><i>(Aneks. Tab 1 Tabelat permbledhese)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin e vene ne dispozicion por edhe nga konstatimet pergjate vizites ne institucion, kontatohet se UniBa ka mireorganizuar mbarevajtjen e ketij program studimi permes ndarjes se pergjegjesive dhe ngritjes se njesive/grupe perkatese te kontrollit te cilesise apo matjes se performances. Kordinatori i departamenti eshte emeruar me urdherin e Rektorit te institucionit. Detyrat e koridnatorit jane te shprehura qarte permes nje dokumentacioni 36/b ku jane te specifikuara konkretisht, megjithese ky kordinator nuk u kontaktua gjate vizites ne institucion, dhe emri i tij nuk rezulton tek listat e stafit te brendshem te viit 2020 2021, por ne vitin akademik 2019 2020.</p> <p><i>Dok 36 a. Urdher i brendshem, nr 111, dt 20.12.2019</i></p> <p><i>Dok 36 b Detyrat e kordinatorit</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit ka ne perberje kater departamente;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit; 2. Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit;



organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 4. Njësia

kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

3. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional;

4. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve;

Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave”.

FSHSTS në vitin e fundit akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij **89 pedagogë gjithsej**, ndër të cilët, 42 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 47 staf akademik me kontratë, (PAK).

Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2021-2022:

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional;

- 7 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada;
- 7 PAK, ndër të cilët, 4 me tituj / grada;

Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit:

- 7 PAE, ndër të cilët 6 me tituj / grada;
- 4 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada;

Departamenti i Shkencave të Sielljes dhe Shëndetit:

- 7 PAE, ndër të cilët 6 me tituj / grada;
- 9 PAK, ndër të cilët 6 me tituj / grada;

Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve:

- 21 PAE, ndër të cilët 6 me tituj / grada;
- 27 PAK, ndër të cilët 11 me tituj / grada;

Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Turizmit rekreacionit që është përgjegjës për programin e studimit për kater vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:

Për vitin akademik **2018-2019**, (7 PAE / 5 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 7 / 3;

Për vitin akademik **2019-2020**, (7 PAE/ 2 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 0;

Për vitin akademik **2020-2021**, (8 PAE / 0 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 3 / 5;


Për vitin akademik **2021-2022**, (8 PAE / 2 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 1;

	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit te vene ne dispozicion, por edhe nga diskutimet ne institucion me shefin e departamentit, dhe stafin konstatohet se:</p> <p>Ka ndryshime te medha ne staf te brendshem qe nga 2018 2019, duke filluar qe nga cdo vit ka 1 shef departamenti;</p> <p>Nr i personave me grade eshte shume i ulet, pjesa me e madhe eshte me Msc dhe jane te rinj. Nuk eshte se 3 vite jane te njejtet pedagoge, ka shume levizje dhe ardhje te reja. Pedagoge te rinj, shume lende japin njekohesisht, si mund te garantohet cilesia me mesidhenie me tej? Nderkohe qe mungojne pedagoge te jashtem speciliste dhe me grada. Nga ana e stafit kjo u justifikua me mungesen dhe bllokimin aktual te procesit te doktoraturave dhe prandaj kane terhequr 1 (nje) staf me doktore jashte vendit.</p> <p><i>GVJ sugjeron forcimin e ketij departamenti, investimi ne burime njerezore me staf cilesor, permanent qe te krijojte stabilitet dhe siguroje cilesi ne mesimdhene dhe mesimnxenie. Sugjerohet rritje e profesionalizmit te nje pedagogu ne 2 apo 3 lende te caktuara dhe mos ndryshimi ne lendet qe jep, me qellim qe te rritet aftesimi i tij ne keto lende, perndryshe do te kete problematika ne dhenie te koncepteve baze.</i></p> <p><i>(Aneks. Tab 1 Tabelat permbledhese) tab 1, 2. Fq 1, 2 3</i></p>				
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Sipas statusit te ketij institucioni (<i>Dok 2 Statusi IAL</i>), brenda ketij institucioni jane ngritur disa njesi qe jane pergjegjese per mbarevajtjen e cilesise dhe kontrollit te performances si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njesia e zhvillimit te Kurikules dhe Cilesise (NJZHKC) me nje dretues dhe 3 kordinatore; • Keshilli i Etikes dhe Shanseve te Barabarta; • Komisioni i Vleresimit te Performances; • Komisioni i Sigurimit te Standarteve te Cilesise; <p>Perveç kesaj departamenti pergjegjes per ofrimin e ketij program studimi ka angazhuar edhe pedagoge me kohe te pjesshme duke u munduar te profilizojte ato me lendet qe japin mesim. Ne kete menyre, njesia kryesore pergjegjese permbush detyrimin ligjor per organizimin e strukturs akademike, dhe sugjerohet te kihen ne vemendjen dhe permiresim te cilesise mesimdhene sugjerimet e kriterit te mesiperm. <i>Dok 2 Statusi IAL</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="566 1825 774 1926">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="774 1825 981 1926">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="981 1825 1173 1926">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1173 1825 1339 1926">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Grupi i ekspertëve të jashtëm, pas shqyrtimit të Dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Manaxhim ne Turizem, Rekreacion dhe Evente”, takimeve gjatë vizitës në UniBa dhe dokumentave shtesë pas vizitës në institucion, thekson se DMTR, disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p> <p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, programi i studimit është organizuar sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar dhe rregullores së programit të studimit. GVJ, pas shqyrtimit të dosjes së vetëvlerësimit, RVB-së dhe dokumentacionit të paraqitur nga DMTR gjatë vizitës në institucion, konstatoi se programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit European të transferimit të kreditve (ECTS) të cilat zhvillohen në tre vite akademike të ndara në 6 semestra.</p> <p><i>Dok 53, Ligji arsimit te larte nr 80/2015</i></p> <p><i>Dok 55, VKM 41, dt 24.01.2018</i></p> <p><i>Dok 14 B Plani Mesimor per programin e studimit MTRE ndare sipas veprimtarive formuese</i></p> <p><i>Dok 14 A Plani Mesimor per programin e studimit MTRE</i></p> <p><i>Dok 4. Plani Strategjik i zhvillimit te programit</i></p> <p><i>Dok 7: Rregullore e programit Bachelor Manaxhim Turizem, Rekreacion dhe Evente, neni 2, 3 fq 3.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë</p>	<p>Per te patur nje plan mesimor me eficient dhe cilesor i cili do te siguroje transmetimin e njohurive te duhura, eshte e nevojshme qe rekomandimet e meposhtme te merrren parasysh:</p> <p><i>Te riorganizohet nje shperndarje e krediteve dhe e oreve mesimore sipas rendesise se lendeve/moduleve. Keshtu te</i></p>

<p>e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p><i>perfshihen me shume lende me pak kredite dhe jo te gjitha lendet te jene me 6 kredite. Nuk mund te jene me 6 kredite dy lende me numer te ndryshem te oreve.</i></p> <p>Lendet jane te grupuara si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Lende baze – 6 lende 36 kredite = 20% B. Lende karakterizuese 18 lende, 96 kredite = 53.3% C. Lende nderdisiplinore/integruese 4 lende, 18 kredite = 10% D. Lende Plotesuese 3 lende, 18 kredite – 10% E. Detyrimet permbyltese 1 lende, 6 kredite – 3.3% <p>Jane dhene sugjerimet perkatese per nje riorganizim te lendeve ne terma te formulimit te tyre, te permbajtjes dhe syllabuseve perkatese me qellim qe te sigurohet transmetimi i dijeve aftesive dhe kompetencave te duhura.</p> <p><i>Dok 14 B Plani Mesimor per programin e studimit MTRE ndare sipas veprimtarive formuese</i></p> <p><i>Dok 14 A Plani Mesimor per programin e studimit MTRE</i></p> <p><i>Dok 4. Plani Strategjik i zhvillimit te programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit permbajne planin mesimor, ku perfshihen informacionet e nevojshme per ngarkesen mesimore, oret ne auditor/jashte auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe menyren e vleresimit te dijeve etj.</p>	<p>Ne lidhje me menyren e vleresimit te njohurive, ne aneksin me tabela vihet re se institucioni eshte munduar te standartizojte dhe vendose brenda kornizave elementet e vleresimit, por vihet re se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Jo te gjitha syllabuset e respektojne tabelen e vleresimit te njohurive sipas kategorive: <ul style="list-style-type: none"> • <i>provim final 50;</i> • <i>ndjekja e lendes dhe pjesemarrja aktivee 10%;</i> • <i>plotesimi i detyrimeve (laboratore, detyra kursi) 20%;</i> • <i>testime gjate vitit 20%;</i> 2. Referuar tabelës me lart perfshihet elementi laboratore nderkohe qe ne tabelen qe tregon shperndarjen e oreve te studenteve sipas ketij program studimi rezulton se oret laboratorike mungojne, pra studentet ne kete program studimi nuk kane ore laboratorike. Sugjerohet qe ne ardhmen te perfshihen oret laboratorike ne ngarkesen e studenteve dhe te reflektohen keto ndryshime ne syllabusat perkates. <p><i>C Aneks me Tabela, tab 13: Ngarkesa Totale ne auditor e studenteve per format e mesimdhënies ne programin e studimit, per secilin program, fq 19</i></p> <p><i>C. Aneks me tabela, tab 15 Forma e kontrollit te njohurive, fq 20.</i></p>



<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e ketij program studimi si dhe rregullorja e departamentit janë dokumenta të rëndësishëm që mbeshtesin mbarevajtjen e ketij program studimi. Në këto dokumenta tregohen kriteret e pranimit, transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve. Sugjerohet që plani mesimor të reflektojë edhe shpërndajrën e krediteve sipas semestrave përkatës, pasi në këtë mënyrë reflektohet shpërndarja e drejtë e numrit të krediteve për çdo vit dhe semester.</p> <p><i>Dok 4. Plani Strategjik i zhvillimit të programit</i></p> <p><i>Dok 7: Rregullore e programit Bachelor Manaxhim Turizem, Rekreacion dhe Evente</i></p> <p><i>Dok 14 A. Plani mesimor Ba MTRE 2020</i></p> <p><i>Dok 14 B Tabela e planit mesimor e ndare sipas aktiviteteve</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e detajuara sipas viteve të studimit nuk përmbajnë pjesën e miratimit të kokene të tyre. Brenda syllabuseve vihet re dhe u konstatua edhe nga takimi në institucion se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Literaturat shpesh janë të vjetra në kohë. Sugjerohet përditësimi i tyre me literature të viteve të fundit si dhe përfshirja e literatures në gjuhën shqipe. Institucioni mbështet stafin në kërkimin e tyre shkencor por edhe në kërkesat që mund të kenë për blerje të literatures në gjuhën e huaj; 2. Sugjerohet që stafi të përfshijë edhe leksionet e veta në gjuhën shqipe në syllabuset përkatëse të shoqëruar me literature e huaj të përdorur; 3. Sado që studentet mund të kenë njohuri të gjuhës së huaj perseri niveli bachelor orienton kryesisht përdorimin e gjuhës shqipe, atëherë me tepër që ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe; <p><i>Dok 19 Syllabus v 1</i></p> <p><i>Dok 19 Syllabus v 2</i></p> <p><i>Dok 19 Syllabus v 3</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Ky program studimi nuk është ndryshuar që në krijimin dhe lancimin e tij për herë të parë në vitin 2018-2019. Që nga ajo kohë me kalimin në një fakultet dhe departament tjetër, ky program ka kaluar në një proces që presupozohet të sjellë rritje dhe cilësi të bashkuar me rritjen e numrit të studentëve. Megjithatë përmirësimet e syllabuseve, konstatohet se ato ende janë problematike në brendësi të tyre si nga literatura, përplasja e temave, e lendeve të panevojshme apo mosmarrja e koncepteve të drejta, gjeje dhe cilësive dakortohet edhe në vizitën në institucion, por janë reflektuar dhe shpjeguar edhe në kriteret e mesipërme. Vihet re një përpjekje nga ana e</p>


	<p>drejtuesit te departamentit per te permiresuar cilesine dhe mbajtur ne kontakt dhe marredheniet e mira dhe cilesore me stafin e brendshem.</p> <p><i>Nje marketing me i mire i programit te studimit se sa vete i institucionit, nje qasje me e forte ne shkolla e mesme per kete program studimi, jane disa nga sugjerimet e dakortesuara edhe me vete stafin e brendshem te ketij program studimi.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Manaxhim ne Turizem, Rekreacion dhe Evente”, bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, VKM Nr. 879, datë 12.18.2019 dhe në rregulloren përkatëse të programit të studimit është organizuar në leksione, seminare dhe praktikë. Ndarja në kategori (A, B, C, D dhe në E) është në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Disiplinat e formimit bazë, të cilat synojnë pajisjen e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehi praktike për krijimin e bagazhit të duhur shkencor që përcaktojnë formimin e përgjithshëm. Ato zënë 15%-20% të krediteve dhe synojne pergatitjen metodologjike dhe kulturen e pergjithshme.</i></p> <p><i>Disiplinat e formimit karakterizues, - pergatitje per disipinen shkencore B, plotësojnë kuadrin e njohurive teorike dhe aftësive praktike të studentëve dhe përbëjnë 50%-55% të krediteve.</i></p> <p><i>Grupi i lëndëve ndërdisiplinore dhe integruese të ngjashme dhe/ose plotësuese me disiplinat karakterizuese apo profilin e programit, si nendisiplina, profile dhe grup lende me zgjedhje C, ato zënë 12%-15% të krediteve.</i></p> <p><i>Lëndë plotësuese, synojnë të pajisin studentët me njohuri më të gjera rreth gjuheve te huaja, njohuri informatike, praktika profesionale: Lëndët plotësuese përbëjnë 3%-5% të krediteve</i></p>

	<p><i>Detyrime përmbyllëse, E (3%-5% të krediteve) lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.</i></p> <p><i>Dok 4. Plani Strategjik i zhvillimit të programit</i></p> <p><i>Dok 7: Rregullore e programit Bachelor Manaxhim Turizem, Rekreacion dhe Evente</i></p> <p><i>Dok 14 A. Plani mesimor Ba MTRE 2020</i></p> <p><i>Dok 14 B Tabela e planit mesimor e ndare sipas aktiviteteve</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënëit dhe aftësisimit profesional.</p> <p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> <p>Kriteri 7. Përbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar ne dokumentacionin e vene ne dispozicion por edhe te reflektuar nga diskutimi me stafin e ktij departamenti si dhe me drejtuesin e departamentit, ne lidhje me emertimet e lendeve sipas profilit te programit u vune re disa problematika qe u sugjeruan te reflektohen ne permiresimet e metejshme te ketij program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Problemet e identifikuar nga analiza e syllabuseve dhe plani mesimor me veprimtarite formuese jane te tipit: probleme te emertimit te lendeve, te literatures, te permbajtjes se temave brenda syllabuseve dhe te perplasjes se tyre midis lendeve te ndryshme, apo panevojshmeri te lendeve te caktuara, si dhe nje nevojje e shperndarjes se krediteve dhe oreve sipas rendesise se lendeve, si dhe e fundit e riorganizimit te lendeve sipas peshes specifike qe kane te tri disiplinat brenda programit te studimit: turizem, rekreacion dhe evente, pra qe secila prej tyre te perfaqesohet ne menyre pothuajse te njejte brenda programit dhe planit mesimor; - Probleme te emertimit dhe perplasjes se temave midis lendeve te duhur te lendeve: psh lenda Hyrje ne ne industrine e turizmit dhe lenda Baza Turizmi kane perplasje te temave te caktuara midis tyre; - Sugjerohet qe Shkrimi akademik te ndahet nga Metoda Kerkimi dhe te zhvillohen si lende te vecanta, nderkohe qe tema qe i perkasin Shkrimit akademik te mos trajtohen ne lende te tjera pasi krijohet nje ngarkese dhe mbivendosje konceptesh; - Te rishikohen temat e lendeve Siper marrje ne Turizem, Teknologji Informacioni, dhe te sillen per turizmin me nje permbajtje sipas emertimit te lendes; - Sugjerohet qe per cdo lende te perfshihet te pakten 1 tekst me te njejtin emertim si edhe vete lenda. Psh lenda: <i>Marketing i rekreacionit outdoor dhe parqeve</i> nuk ka literature qe perputhet me titullin dhe contentin; - Sugjerohen te perfshihen lende qe trajtojne fenomene te rendesishme te koheve te sotme si Manaxhim Turizmit te



Qendrueshem, Marketing i Turizmit, etj. Nderkohe qe mund te hiqen lende si Ekoturizmi i cili per vete ndikimet ne mjedis dhe efektin e ulet ekonomik he social nuk sugjerohet tashme ne literaturat e koheve te fundit;

Lenda disenjimi i programeve te rekreacionit eshte e paqarte dhe ka nevojte per rregullim, te eliminohen perplasjet me lenden historia dhe filozofia e rekreacionit si dhe te perdoret nje literature e pershtatshme. Lendet: histori dhe filozofi e rekreacionit nuk mund te jene 1 lende me vete, por te bashkohet me lenden disenjimi i programeve te rekreacionit, permes nje emertimi te thjeshte te lendes;

Lenda Sipermarrrja ne turizem dhe rekreacion ka mjaft perplasje ne koncepte me rekreacioni si dhe me bazat e turizmit si dhe ka 2 tema te fundit qe i perkasin hyrje ne industrine e turizmit. Ka edhe paqartesi ne koncepte. Psh tema e 2: Pse rekreacioni dhe turizmi eshte tregtar? Kjo lende ka nevojte te riformatohet syllabusi i vet;


Promocioni i eventeve te zevendesohet me Manaxhim ose Marketing eventesh me qellim qe te perfshihen me shume dhe me teper koncepte se sa thjesht promocioni;

Lenda Marketingu i Turizmit te perfshihet tek lendet baze te ketij program studimi. Po keshtu edhe lenda Manaxhim turizmit te qendrueshem;

Turizmi i trashegimise dhe turizmi i sportit te ulen kreditet dhe te organizohen ne module te bashkuara, sepse nuk ka cfare te besh 15 jave aty te futen ne nje format: forma alternative te turizmit. Ne kete menyre mund te perfshihen ehe forma te tjera te turizmit;

Lende qe nuk kane lidhje me turizmin si sjellje konsumatore, manaxhim financiar etj te sillen me koncepte ose te pakten 2 kapituj per industrine e turizmit qe t'i sherbeje programit dhe dija te transferohet ne fushen e turizmit dhe studentet te bejne lidhjen e koncepteve. Apo lendet mikro dhe makroekonomi kur flitet per konceptet e kerkeses dhe ofertes mjaft mire mund t'i huajzoje lenda baza turizmi apo konceptet e ekonomise kombetare ne lenden makroekonomi perseri ne lenden baza turizmi. Temat kerkesa agregate apo matje e GDP mjaft mire mund te ilustrohen me shembuj per turizmin duke rritur aftesite e studenteve edhe ne kete drejtim. Po keshtu edhe per lenden manaxhimi i projekteve te sillet me shembuj per turizmin;

Literatura te perditesohet ne vazhdimesi dhe cdo vit. Vihet re literature ose shume te vjetra, ose mungesa te literatures ne gjuhen shqipe, ose mbingarkese qe ne vitin e pare te studentit me literature te huaj kur ai sapo vjen nga shkolla




	<p>e mesme, si dhe mungesa e literatures sipas emertimit te cdo lende. Pavaresisht se planet mesimore te ketij programi nuk jane ndryshuar qe ne krijimin e tij, sigjerohet se stafi i ketij departamenti se bashku edhe me stafin e jashtem duhet te diskutoje ne menyre te detajuar brendine e syllabusit dhe konceptin e lendes perkatese me njeri tjetrin. Kjo jo vetem per te eliminuar perplasjet por edhe diskutuar cilesine e koncepteve qe u transmetohen studenteve, me qellim qe te rritet ndjeshmeria dhe pergjegjshmeria per konceptet qe stafi transmeton tek studentet permes ketij program studimi. Mbase eshte e nevojshme edhe perfshirja e eksperteve te fushes jo vetem ne permiresimet pas akreditimit te ketij plani mesimor, por edhe te mesimdhënies permes guest speaker. Keto u diskutuan edhe pergjate vizites ne institucion;</p> <p><i>Dok 19 Syllabus v 1</i> <i>Dok 19 Syllabus v 2</i> <i>Dok 19 Syllabus v 3</i> <i>Dok 14 A. Plani mesimor Ba MTRE 2020</i> <i>Dok 14 B Tabela e planit mesimor e ndare sipas aktiviteteve</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive dhe krijimin e kushteve të duhura për një kompetencë të nevojshme në të ardhmen, kur ata të ushtrojnë profesionine tyre (<i>pas masterit</i>). Ky program u krijon mundësi, të thellohen në ciklin e dytë, Master Profesional ose Master i Shkencave.</p> <p><i>Dok 19 Syllabus v 1</i> <i>Dok 19 Syllabus v 2</i> <i>Dok 19 Syllabus v 3</i> <i>Dok 14 A. Plani mesimor Ba MTRE 2020</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Per te qene me koherente me evoluimin e tregut dhe per te reflektuar me shume studimet e tregut ne permiresimet e planit mesimor, te perkthyer me tej ne dije dhe kompetenca per studentet dhe mundesi punesimi te tyre, gjykojme qe studime te tregut te realizohen perpara permiresimit te ketij programi studimi, si dhe pas diplomimit te studenteve, per te analizuar perputhshmerine e dijeve te perftuara me tregun e punes, sikurse edhe rrjetesimi i nje diversiteti bashkepunimesh me institucione publike dhe private brenda vendit, me eksperte te fushes, etj.</p> <p><i>Dok 32: Institucionet dhe organizatat bashkepunuese, tab 5</i> <i>Dok 29. Te dhena per punesimin e studenteve</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																								
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) në programin e studimit Bsc ne :Manaxhim ne Turizem, Rekreacion dhe Evente përmbush kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë kater viteve akademike janë si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2018 - 2019 kanë dhënë mësim 8 pedagogë gjithsej nga të cilët 7 PAE dhe 1 PAK (88% / 12%).</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>3 Dr./PhD</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>4 Msc</td> <td>1 Msc</td> </tr> <tr> <td>7 PAE</td> <td>1 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim 15 pedagogë gjithsej nga të cilët 13 PAE dhe 2 PAK (86.6% / 13.4%).</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>7 Dr./PhD</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>6 Msc</td> <td>2 Msc</td> </tr> <tr> <td>13 PAE</td> <td>2 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim 20 pedagogë gjithsej nga të cilët 18 PAE dhe 2 PAK (90% / 10%).</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1 Prof. Asoc.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>7 Dr./PhD</td> <td>1 Dr./PhD</td> </tr> <tr> <td>10 Msc</td> <td>1 Msc</td> </tr> </tbody> </table>	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	3 Dr./PhD	-	4 Msc	1 Msc	7 PAE	1 PAK	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	7 Dr./PhD	-	6 Msc	2 Msc	13 PAE	2 PAK	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	1 Prof. Asoc.	-	7 Dr./PhD	1 Dr./PhD	10 Msc	1 Msc
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																								
3 Dr./PhD	-																								
4 Msc	1 Msc																								
7 PAE	1 PAK																								
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																								
7 Dr./PhD	-																								
6 Msc	2 Msc																								
13 PAE	2 PAK																								
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																								
1 Prof. Asoc.	-																								
7 Dr./PhD	1 Dr./PhD																								
10 Msc	1 Msc																								




	18 PAE	2 PAK										
	Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim 21 pedagogë gjithsej nga të cilët 19 PAE dhe 2 PAK (90% / 10%).											
	<table border="1"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1 Prof. Asoc.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>9 Dr./PhD</td> <td>1 Dr./PhD</td> </tr> <tr> <td>9 Msc</td> <td>1 Msc</td> </tr> <tr> <td>19 PAE</td> <td>2 PAK</td> </tr> </tbody> </table>		<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	1 Prof. Asoc.	-	9 Dr./PhD	1 Dr./PhD	9 Msc	1 Msc	19 PAE	2 PAK
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>											
1 Prof. Asoc.	-											
9 Dr./PhD	1 Dr./PhD											
9 Msc	1 Msc											
19 PAE	2 PAK											
	<p>Per te katert vitet akademike plotesohet kriteri ligjor qe stafi PAE mbulon mbi 70% te ngarkeses mesimore.</p> <p><i>Aneks, Tabelat permbledhese Tab 1, fq 1 dhe 2</i></p> <p>24. Te dhena tabelore per personelin akademik - Tabela 6.1</p>											
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për 2018-2019, 37% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 63 % janë Msc; - Për 2019-2020, 46.6 % e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 53.4% janë Msc; - Për 2020-2021, 45% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 55% janë Msc. - Për 2021-2022, 52.3% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 47.7% janë Msc. <p>Ne lidhje me personelin akademik me kohe te pjesshme, <u>GVJ sugjeron te shfrytezohen eksperte te fushes si dhe profesore me tituj e grada dhe me koherence te gjate ne treg.</u> Ne nje kohe qe ky departament eshte ne nje proces zhvillimi dhe rritjeje, nevoja per profesore te jashtem eshte me e madhe pasi ato mund te shfrytezohen jo vetem per mesimdhenie por edhe eksperience dhe ndarje te per ceshtje specifike te fushes dhe aplikimit te tyre ne vendin tone.</p> <p><u>Gjithashtu GVJ sugjeron qe stafi i brendshem te mbaje te njejtat lende me kalimin e viteve me qellim qe te rriten kompetencat e tyre ne lende te caktuara dhe te rritet edhe profesionalizimi brenda fushes se turizmit.</u> Nderkohe qe vitet e para te ofrimit te ketij programi studimi eshte vene re ndryshim i stafit, ndryshim ne drejtim te departamentit, ndryshime qe kane ardhur duke u stabilizuar bashke me normalizimin e</p>											

	<p>numrit te lendeve qe jep aktualisht cdo pedagog krahas pergjegjesive te veta administrative brenda institucionit.</p> <p>Dok 20 a. Cv e stafit akademik te programit te studimit</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Ka vend per me shume bashkepunim me punedhenesit, per nje intership me cilesor dhe te realizuar prane institucioneve qe kane nevojte per kete kategori te studenteve.</p> <p><i>Nderkohe sugjerohet nje perfshirje me e madhe e botes se biznesit shqiptar ne cdo veprim, permiresim apo ndryshim te ketij program mesimor. Sugjerohet nje bashke-krijim i kurrikules me biznesin, nje perfshirje me aktive te grupeve apo nismave te krijuara brenda departamentit apo fakultetit me qellimin e permiresimit cilesor dhe eficient te ketij program studimi. Dok 34. Mareveshje bashkepunimi efektive</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Barlti ne dokumentacionin e vet baze ka percaktuar qarte detyrat e personelit akademik dhe ndihmesakademik duke specifikuar pergjegjesite e tyre per zbatimin e programeve te studimit si dhe per permiresimin e metodave te mesimdhënies. Nga ana tjeter, mundesite qe ofron UniBa permes programeve te shkembimit Erasmus si te stafit ashtu edhe studenteve jane nje menyre e mire per te motivuar dhe nxituar ato drejt mesimdhënies dhe metodologjise se re.</p> <p>Dok 46 Udhezues per perdorimin e struktures se Teknologjise se Informacionit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1



Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Institucioni nuk ka një udhëzues të dedikuar për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve apo të ndonjë moduli specifik, në nivel institucional. Por në nivel institucional është hartuar një dokument në formatin: “<i>Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit Menaxhim ne Turizëm Rekreacion dhe Evente</i>”, i cili mundëson rregullimin e kuadrit të përgjithshëm institucional për mësimdhënien dhe të nxënit duke e vendosur atë si mision të programit të studimit. Një prej objektivave kryesor për arritjen e misionit është “përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet mekanizmit të përdhijes aktive të studentëve në procesin e të mësuarit nëpërmjet nxitjes së të mësuarit kritik.</p> <p><i>GVJ konstaton se plani strategjik i programit nuk përcakton periudhën kohore kur është hartuar ky dokument por as periudhën kohore për të cilën ky dokument do të ketë vlefshmëri. Mbështetur në këtë gjetje rekomandojmë hartimin e një plani startegjik i cili të përcaktojë qartë periudhën kohore kur do të veprojë gjithashtu edhe aktivitetet që parashikohen të realizohen për përmbushjen e objektivave kryesor dhe linjave përkatëse. Dok.4. Plani startegjik per zhvillimin e programit</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Po në këtë drejtim, GVJ thekson se: referuar 4a. Plani i Veprimit DTMR për vitin akademik 2020.2021 dhe 2021.2022, ku paraqiten aktivitetet e realizuara nga departamenti përgjegjës për programin konstatohen se realizohen mbledhje periodike (dy herë në muaj), javën e parë dhe javën e tretë të çdo muaji nga DTMR të cilat kanë si objekt të tyre kryesor monitorimin e procesit të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Nga plani i veprimit DTMR vihet re se, institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të metodave dhe formave të mësimdhënies duke i përfshirë studentët në mbledhjet periodike të deprtamentit për dhënien e vlerësimeve të tyre rreth zhvillimit të procesit mësimor, realizimit të praktikave, konsultimve 4a. Plani i Veprimit DTMR për vitin akademik 2020.2021 dhe 2021.2022. Lidhur me trajtimin e ankimimeve, sipas nenit 7 dhe 8 të rregullores së DTMR te faklutetit, studentët kanë të drejtë të ankohen në mënyrë individuale ose kolektive kur gjykon se procesi mësimor nuk</p>

	<p>zhvillohet në mënyrë të rregullt, kur njohuritë e ofruara nuk i'u përgjigjen kërkesave a nivelit të premtuar ose kur, si pasojë e metodës së përdorur në mësimdhënie Në takimin e zhvilluar me studentët gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi se studentët e ushtronin këtë të drejtë dhe se ishin pjesëmarrës aktive në mbledhjet e departamentit.</p> <p><i>Dok. 7. Rregullore e prog. Stud. BSc, në MTR</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Duke pasur parasysh natyrën e këtij programi studimi, metodat e përdorura në funksion të mësimdhënies dhe të nxënit, rezultojnë të zhvillohen në trajtën e leksioneve dhe seminareve në auditor duke synuar përvetësimin e njohurive nga studentët si dhe nxitjen e komunikimit mes studentëve dhe pedagogëve si dhe në trajtën e kërkimit të aplikuar në terren duke synuar gërshetimin e teorisë me aftësitë praktike. Në Universitetin Barleti, në nivel qëndror është ngritur dhe funksionon struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel Universiteti është Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë. Njësia për Zhvillimin e Kurrikulave e Cilësisë në nivel njësie kryesore, shërben si mekanizëm i rëndësishëm monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i aftësive mësimdhënëse se të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Kjo strukturë (NJZHKC) është përgjegjëse për të zhvilluar mekanizmat e monitorimit dhe të vlerësimit në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik në rang institucional. <i>Doc. 8. Rregullore e NJZHKC</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>NJZHKC ka realizuar pyetësorët e studentit në rang institucional dhe më pas ka bërë analiza dhe ka përpiluar raporte. Këto analiza kanë për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, kjo e shoqëruar dhe me një analizë SWOT. Njësia realizon edhe një analizë krahasuese për pyetjet e njëjta dhe përgjigjet e studentëve në vite të ndryshme. Struktura përkatëse në punën e saj, harton dhe projektton një raport me propozime dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe ja dërgon çdo Njësie Kryesore. Sipas procedurës së miratuar, njësia këto rekomandime i bën objekt të diskutimit me stafin e saj akademik. Pas analizës në Njësinë Kryesore, mendimet mbi këto problematika çohen në Rektorat dhe ai më pas dilet me një plan masash. Në këtë vlerësim nga ana e njësisë së cilësisë është dhe programi i studimit Bsc. Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente me rekomandimet përkatëse. GVJ e vlerëson si një praktikë të mirë këtë procedurë, por do të rekomandonte që për planin e</p>

	<p>masave, të mund të ketë një konsultim paraprak edhe me studentë.</p> <p><i>Rekomandim i GVJ-së është bërja funksionale e njësisë të sigurimit të cilësisë, në rang fakulteti duke u mbështetur tek përvoja shumë e mire e funksionimit të DKVI-së .</i></p> <p><i>Doc 37. Raport i vlerësimit të brendshëm të studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në programin e studimit Bsc. Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente, sipas dokumentacionit në DVV, RVB, por edhe në takimet që GVJ zhvilloi në institucion, konstaton se format e mësimdhënies që përdoren në procesin mësimor janë metodat standare si leksione, seminare, praktika në terren, detyrat e kursit dhe tema të diplomave. Format e lartpërmendura mbeten të hapura për përmirësime dhe pasurohen periodikisht me elementë të rinj.</p> <p><i>Doc 7. Rregullore e prog. Stud. BSc, në MTRE;</i></p> <p><i>Doc. 19. Syllabus Viti I, II, III;</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik njeh dhe respekton diversitetin e karaktereve dhe interesave individuale të studentëve dhe përshtat metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies me këto vecori. Raporti midis formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies ndryshon në varësi të natyrës së moduleve të programit, duke tentuar që në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve të rrisë kontaktin e drejtpërdrejtë të studentëve me objektet konkrete të profesionit të tyre të ardhshëm, nëpërmjet rritjes së peshës së praktikave mësimore dhe profesionale në raport me format e tjera të mësimdhënies/mësimnxënies.</p> <p>Personeli akademik, në këtë program studimi, përdor metoda alternative gjatë mësimdhënies si prezantime në powerpoint, mënyra audiovizive, biseda interaktive, etj. <i>Në programin e studimit nuk kanë pasur studentë me aftësi ndryshe, por GVJ rekomandon që edhe për këtë kategori të parashikohet në rregullore mënyra se si do të veprohet.</i></p>

	Në takimet me stafin akademik na u bë me dije se ata i marrin parasysh kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për zhvillimin më efektiv dhe cilësor të mësimin, leksioneve apo seminareve, për ti bërë ato më efektive dhe tërheqëse.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	UniBa, u siguron stafit akademik logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor duke bërë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. <i>(RVB)</i> Gjatë vizitës në mjediset e institucionit rezultoi se infrastruktura dhe baza materiale në auditore dhe laboratore, në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve, lejon dhe mundëson aplikimin efektiv të metodave të shumëllojshme të mësimdhënies. Sallat e leksioneve seminareve janë të përshtatshme, të pajisura me videoprojektor, tabela për të shkruar, kanë sistem ngrohje, etj
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik efektiv rezulton se formimi profesional i tyre është në përputhje me modulet dhe lëndët të cilat ata lektorojnë duke demonstruar kompetencë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. <i>(Doc 20a. Cv e personelit akademik I, II, III)</i> Nga takimi me lektorët dhe GVB-në u njohëm me disa prej metodave që ata përdornin ku shumë efikase vlerësohet realizimi i praktikave mësimore në subjekte private në përputhje me objektivat mësimorë të këtij programi.
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Ashtu siç u theksua edhe më lart, Institucioni me anë të strukturave të cilësisë, vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vlerësimit. <i>(Doc 8a. Plani i punës se NJZHLC-së 2020-2021)</i>
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Personeli akademik për ti bërë tërheqëse dhe interaktive orët e mësimin përdor projektorët për prezantime poëerpoint për dhënien e leksioneve dhe prezantimeve. <i>(Vizita në institucion)</i>
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë	Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është interaktiv dhe stimulon punën e pavarur të studentëve. Këtij qëllimi i shërben në mënyrë të vecantë rritja e peshës së detyrave dhe projekteve të kursit në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve.

<p>udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Puna për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit shtrihet në kohë për disa javë dhe kërkon angazhimin intensiv të studentëve jashtë orëve të mësimi. Si e tillë ajo inkurajon punën në grup të studentëve paralelisht me kontributet individuale të secilit prej tyre. Ndonëse punë e pavarur e studentëve përgatitja e detyrave dhe projekteve të kursit monitorohet e mbështetet nga personeli akademik gjatë të gjithë kohës së realizimit të tyre.</p> <p><i>GVJ nuk identifikoi forma dhe metoda të tjera, (pervec platformave Google Classroom te zhvillira gjate pandemisë), të përdorimit të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve që ndërthuren me teknologjinë. (Doc 48. Manual i përdorimit të Google Classrrom për pedagogët)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.3</p>	
<p>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës që GVJ realizoi në UniBa, u konstatua se programi mësimor Bsc në MTRE e zhvillon procesin mësimor e shkencor në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore me kushte optimale dhe profesionale të kampusit univeristar 2 të UniBa, ku ndodhet Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, në të cilin zhvillohet programi i studimit. Mirëmbajtja e mjediseve kryhet rregullisht nga specialist të UniBa dhe në raste specifike me specialist të kontraktuar nga jashtë.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Lidhur me hapësirat e klasave të leksioneve për një student nga përlllograitjet sipas (Tabelës 3), në dokumentin me emërtim.(<i>Doc 42b. Të dhëna për infrastukturën</i>) konsatohet se varion nga 1.08 m²/student në katin e parë dhe 2.01m²/student në katin e tretë duke mbajtur në konsideratë se standarti i përcaktuar në legjislacionin në fuqi është 2.48 m²/student. Në raport me numrin e studentëve që ky program ka, 14 stuentë në të tri vitet hapësirat konsiderohen të mjaftueshme. Gjatë vizitës në institucion vumë re se sallat ishin të pastra dhe të mirëmbajtura dhe të pajisura me ndriçimin e duhur. GVJ konstaton si nga</p>

	<p>RVB ashtu edhe gjatë vizitës për ekzistencën e ambienteve të dedikuara për procesin mësimor si, klasa leksionesh, klasa seminaresh, laboratorë, zyra pranimi, rekrutimi, regjistrimi, sall mbledhjesh, zyra, biblioteka, holle leximi. <i>Doc 42b. Të dhëna për infrastrukturën.</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve ekziston një infrastrukturë e konsoliduar IT, që ofron shërbime të shumta dhe cilësore (korrespondencë elektronike, kërkim dhe shfrytëzim online të materialeve didaktike dhe shkencore, informim on-line të rezultateve të vlerësimit gjithëvjetor dhe përfundimtar, komunikim elektronik pedagog-student) RVB Me qëllim prezantimin dhe përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa ka hartuar një udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit. Ky dokument është në funksion të menaxhimit të të dhënave, komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe gjithë procedurat rregullat dhe politikat përkatëse, ai përmban çështje si Portali Studentor, Sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentëve SIS Classter, Google Classroom, Intranet dhe GSuit për komunikim të brendshëm, Webfaqja zyrtare e UniBa dhe nënfaqet e grupit Barleti. Sistemi mundëson informimin në kohë reale të studentëve lidhur me rezultatet e tyre dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën për të gjithë procesin. Në kushtet konkrete të ndërprerjes disa mujore të mësimin në auditor, realizimi i mësimin online është mundësuar nëpërmjet platformave të ndryshme. U përdorën gjerësisht gjatë vitit akademik 2019 – 2020 platformat Google Classroom, Skype dhe Hangout Meet. Gjithashtu është konstatuar se institucioni ka hartuar një dokument në formën e një guide instructive për mbështetjen dhe pasurimin e mësimin on-line gjatë periudhës së pandemisë.</p> <p><i>Doc 48.a Manual i përdorimit të Google Classroom për pedagogët</i> <i>Doc 48.b Manual i përdorimit të Portalit Studentor për administrim</i> <i>Doc 48.c Manual i përdorimit të Google Classroom për studentët</i> <i>Doc 48.d Manual i përdorimit të GSuit</i> <i>Doc 48.e Manual i përdorimit të Intranet</i> <i>Doc 48. Manual i përdorimit të SIS Classter për studentët</i> <i>Doc46. Udhëzues për përdorimin e strukturës së TIK.</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të</p>	<p>Për të gjithë modulet e programit mësimor ekziston literatura bazë në gjuhën shqipe, përgatitur nga pedagogët përkatës. Cilësia e literaturës bazë dhe përpuethshmëria e përmbajtjes së tyre me atë të programit të studimit garantoher nëpërmjet</p>

<p>studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>diskutimit dhe miratimit të përmbajtjes së teksteve mësimore në departament. Të mësuarit prej studentëve e lëndëve të formimit profesional mbështetet nga skripte ose tekste mësimore të stafit akademik të departamentit dhe homologëve të tyre në UniBa. <i>Doc 42c. Të dhëna për bibliotekën, MTRE;</i> <i>Doc 43g. Botimet e UniBa 3-5 vitet e fundit;</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Universiteti Barleti dispon bibliotekën e vet që ndodhet në Kapusin 1 dhe në Kampusin 2. Fondi i titujve në bibliotekën e UniBa është 5,250 tituj, <i>Doc Doc 42c. Të dhëna për bibliotekën.</i> Biblioteka në Kapusin 2 ku edhe zhvillohet program i studimit Bch në MTRE ka një fond prej librash me karakter revista shkencore, punimet e konferencave, periodikë të fushave të ndryshme dhe 50 poste leximi dhe poste me kompjutera për ofrimin dhe aksesimin e bibliotekës digjitale të universitetit dhe të bibliotekave on-line ndërkombëtare si, Econ Biz, Research4life, Hinari, AGORA, OARE, ARDI, JTSOR, GOALI. Të gjithë studentët e këtij programi janë anëtarë të bibliotekës. Menaxhimi i bibliotekës kryhet nëpërmjet platformës on-line. Për shkak të pandemisë, UniBa ka shfrytëzuar qasjen në biblioteka digjitale, duke u ofruar punonjësve dhe studentëve të tij falas gamën e gjerë të librave në bibliotekat elektronike.</p> <p><i>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon, që UniBa duhet të rrisë mbështetjen financiare për pasurimin e Bibliotekës me literaturë në fushën e shkencave humane dhe ato sociale, në mënyrë specike me literature per turizmin, sidomos në gjuhë të huaj.</i></p> <p><i>Doc 42c. Të dhëna për bibliotekën, 4 Doc 5. Lisat e teksteve në bibliotekë-MTRE</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nga të dhënat e marra në dokumentin për bibliotekën dhe vizita në bibliotekën e kampusit, 2 në institucion, konstatojmë ekzistencën e një larmi titujsh nga fusha të ndryshme.</p> <p><i>GVJ konstaton që numri i titujve që lidhen me fushën e turizmit duhet të pasurohet si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhë të huaj, veçanërisht të pesë viteve të fundit.</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në</p>	<p>Referuar RVB-së, studentët e programit të studimit, kanë mundësinë që të shfrytëzojnë laboratorët e informatikës, në funksion të zhvillimit të mësimin në lëndë të ndryshme, si dhe të realizimit të detyrave të kursit etj. Gjithashtu edhe auditorët janë të pajisura me kompjuter, projektorë dhe mjete të tjera, në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve.</p>


mënyrë të vazhdueshme nga studentët.									
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Nga vizita në institucion dhe RVB, konstatohet se personeli akademik përdor në funksion të mësimdhënies platforma on-line duke nxitur edhe studentët në përdorimin e tyre. Të gjithë studentët dhe stafi akademik i brendshëm, janë të pajisur me adresa individuale elektronike me domenin @umb.edu.al, për të mundur përdorimin e portalit studentor. <i>Doc 48.a Manual i përdorimit të Google Classroom për pedagogët</i> <i>Doc 48.b Manual i përdorimit të Portalit Studentor për administrim</i> <i>Doc 48.c Manual i përdorimit të Google Classroom për studentët</i>								
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Për të patur akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar, studentët dhe personeli akademik shfrytëzojnë Open Dissertations (Ebsco open dissertations) që është një bashkëpunim i EBSCO me Bibliolabs që sjell një qasje inovative për zhvillimin e kërkimit të disertacioneve doktorale ku janë të dhëna nga disertacione dhe teza nga viti 1995 deri sot. <i>Doc 42c. Të dhëna për bibliotekën</i>								
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Në rregulloren e programit të studimit kemi të përcaktuar se temat e diplomës zgjidhen nga studentët në konsultim me personelin akademik të tyre në mënyrë që temat e tyre të jenë lidhur me problematikat aktuale të turizmit, rekreacionit dhe eventeve, kryesisht në fushën e mësimdhënies. Sipas rregullores, drejtuesit e temave miratohen nga departamenti, ndërsa mbrojtja bëhet e hapur dhe sipas procedurave të parashikura në rregullore.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë	Njësia përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional është NjZhKC, <i>Doc 2.Statuti IAL, 8. Rregullorja e NjZhKC.</i> Brenda kësaj strukture funksionon komisioni i përhershëm "Komisioni i Sigurimit të Cilësisë" i cili si organ kolegjal orienton, këshillon dhe mbështet hartimin

<p>dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>e politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Aktiviteti i këtyre strukturave rregullohet nga “Rregullore e NJZHKC”. <i>Doc 8. Rregullorja e NjZHKC Doc 30. Anëtarët e NJSBC</i></p> <p>Në funksion të përmirësimit të mësimdhënies, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një “Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës” dhe synon të kontrollojë dhe përmirësojë cilësinë e mësimdhënies nga ana e personelit akademik. <i>Doc 11.a Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.</i> Kjo njësi ka miratuar procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo program studimi dhe mbi bazën e saj, kryen aktivitetin në promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies në takimet në institucion, na u theksua dhe përvoja shumë e mirë e fituar në kuadrin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve. (<i>sondazh i kryer nga ASCAL</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit është përgjegjës kryesor për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit bachelor në “Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente”. Departamenti monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon situatën periodikisht. Departamenti i kushton rëndësi përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies edhe nëpërmjet inkurajimit të aktivitetit shkencor të stafit të vet akademik dhe përfshirjes së studentëve në projekte kërkimi në fushën e Turizmit dhe atë të rekeacionit. Kërkimi shkencor dhe aktiviteti botues i stafit akademik analizohen gjithashtu periodikisht në analizat vjetore të departamentit. Performanca individuale vjetore e stafit akademik monitorohet e vlerësohet rregullisht nëpërmjet plotësimit të formularëve të hartuar për këtë qëllim. Si stafi akademik, ashtu edhe ai mbështetës, i janë nënshtruar formave të shumëllojshme të trainimit të tyre personal.</p> <p><i>Doc 43.a Lisat e konferencave, Workshoop, Trajnimeve 2015-2020</i> <i>Doc 43.b Lista e aktiviteteve ndërkombëtare 2015-2020</i> <i>Doc 38. Analiza e depit. Mbi arritjet e objektivave per 2019-2020,</i> <i>Doc 43.d projekte të zbatuara dhe në process</i> <i>Doc 11.a Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se përdoren një sërë metodash në zhvillimin e procesit mësimor. Këto metoda janë kryesisht tradicionale dhe të përdorura gjerë në</p>



reja inovative të mësimdhënies.	komunitetin akademik shqiptar. Krahas metodave ekzistuese GVJ nuk u njoh me ndonjë metodë specifike e cila të përfaqësonte një metodë inovative në këtë proces. <i>Doc 38. Analiza e depit. Mbi arritjet e objektivave per 2019-2020. MTRE</i>
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referuar RVB dhe takimit me personelin akademik dhe atë administrativ gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen përmes trainimeve të vazhdueshme. <i>GVJ konstaton se ka të dhëna vetëm sasiore për realizimin e tyre. Do të ishte në dobi që institucioni të hartonte një raport progress lidhur me rritjen profesionale të personelit akademik i cili të mund të paraqiste nga pikëpamja cilësore arritjet e këtyre kualifikimeve në fushën e turizmit, rekreacionit dhe eventeve. Kjo do ti shërbente arritjes së objektivave të vendosur për tu realizuar nga programi Bch në MTRE.</i> <i>Doc. 43.a Lisat e konferencave, Workshoop, Trajnimeve 2015-2020</i> <i>Doc. 43.b Lista e aktiviteteve ndërkombëtare 2015-2020</i> <i>Doc. 43.c Të dhëna mbi mobilitetin e stfit dhe studentëve</i>
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Nga vizita në nivel institucional, rezulton se cilësia e mësimdhënies promovohet dhe monitorohet nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, e cila është përgjegjëse për koordinimin e procedurave të vlerësimit të njësive akademike të brendshme dhe të jashtme. Këto struktura mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. <i>Doc 8. Rregullorja e NjZHKC;</i> <i>Doc 38. Analiza e depit. Mbi arritjet e objektivave per 2019-2020. MTRE.</i> <i>Doc 30. Anëtarët e NJSBC</i>
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik janë tërësisht përgjegjës dhe të angazhuar në programin e studimit. Vihet re një tendencë pozitive në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies si dhe implementimin e metodave të reja. <i>Doc 38. Analiza e depit. Mbi arritjet e objektivave per 2019-2020. MTRE.</i>


<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Të gjithë anëtarët e departamentit kanë grada shkencore <i>Doc 20.a Cv e personelit akademik I, II, III</i>, në fushat përkatëse të mësimdhënies. Në takimet e zhvilluara në institucion na u tha se disa nga stafi ishin aktualisht të përfshirë në procesin e plotësimit të dosjeve për tituj më të lartë akademikë.</p> <p>Në RVB por dhe nga dokumentacioni i shqyrtuar mund të themi se: DMTR-ja, krijon hapësira dhe lehtëson procedurat në kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit, me anë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. organizimin e veprimtarive shkencore që lidhen me shkencat turizmit, rekreacionit, eventeve dhe mësimdhënies; 2. koordinimin e informacionit për mundësi botimi apo thirrje në veprimtari shkencore ndërkombëtare; 3. Angazhimin e stafit akademik në projekte institucionale, kombëtare e ndërkombëtare; 4. Hartimi dhe aplikimi i projekteve në nivel departamenti¹ 5. angazhimin e stafit akademik në botimin e artikujve; <p>Ndërkohë, stafi akademik është autor i një sërë artikujsh periodikë lokalë/vendas ose të botuar jashtë vendit. Nga shqyrtimi i listës së projekteve të realizuar nga UniBa dhe në mënyrë specifike DTMR, GVJ konstaton pjesmarrje të gjerë në projekte zhvillimore në bashkëpunim me organizata joqeveritare vendase e të huaja. <i>por nuk ka një dokument ku të merret në analizë produkti shkencor që është përfituar prej tyre.</i></p> <p><i>Doc 38.c Lista e aktiviteteve 2018-2021, 43d. Projekte të zbatuara dhe në Proces;</i></p> <p><i>Doc 43e. Relacion mbi konferencën shkencore të organizuar nga DTMR;</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.5


Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

¹ 43d Projekte të zbatuara nga departamenti

40



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit konsatojmë se kriteret e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen qartë në <i>(Kreun III Vlerësimi I studentit)</i>, të kësaj rregulloreje e cila është e miratuar me vendim të senatit akademik i UniBa datë:13.04.2021 dhe mban vulën e këtij institucioni. Krahas këtij dokumenti kriteret e vlerësimit janë të pasqyruara edhe në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit. Rregulloret përcaktojnë sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve, kushtet që duhet të plotësojnë studentët për të hyrë në provim, mënyrën e organizimit të provimeve, shpalljen e rezultateve dhe procedurën e ankimimit të studentëve në rast të pakënaqësive për rezultatet e provimit.</p> <p><i>Doc 7. Rregullore e prog. stud. Bsc.MTRE.</i></p> <p><i>Doc 6a. Rregullore e njësisë kryesore dhe 6b. Reg.Dept. Turizmit, Mikëpritjes dhe Rekreacionit</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët informohen në detaje për të gjitha çështjet e mësipërme dhe sidomos për mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive në fillim të çdo moduli mësimor. Çdo fillim viti student informohen nga përgjegjësi i departamentit dhe koordinatorja e programit lidhur me metodologjinë e testimit, vlerësimit dhe aftësive profesionale. GVJ e konfirmoi këtë edhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion.<i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve kryhet i ndarë në disa kategori:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provim i ndërmjetëm 20%; 2. Pjesmrrja dhe aktivizimi 10%; 3. Detyra e Kursit 20%; 4. Provimi Përfundimtar 50%; <p>Studentët informohen nga titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të FEF si dhe rregulloren e programit të studimit.</p> <p>[plani mësimor, dosja e programit] dokumentacion shtesë.</p> <p>Doc 19. Syllabuset e programit MTRE</p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Në syllabusin e lëndëve dhe moduleve të programit të studimit në rubrikën “<i>Vlerësimi i Vazhdueshëm</i>” konstatohet që testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve kryhet i ndarë në disa kategori:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provim i ndërmjetëm 20%; 2. Pjesmrrja dhe aktivizimi 10%; 3. Detyra e Kursit 20%; 4. Provimi Përfundimtar 50%; <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve “E Drejte Publike” , “Gjuhë Angleze”, “ Baza Menaxhimi”, GVJ vuri re se, në syllabusin lëndor sipas temave nuk paraqitet se në cilën javë të procesit mësimor kryhet provimi i ndërmjetëm dhe ai përfundimtar, duke mbajtur në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga VKM Nr. 41, dt: 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ogruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p><i>Referuar sa më sipër, GJV rekomandon rishikim e syllabuseve dhe plotësimin e tyre sipas detyrimeve të VKM Nr.41</i></p> <p>Doc 19. Syllabuset e programit MTRE</p> <p>Doc. 56. VKM Nr.879, datë 18.12.2019</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Çdo student ka llogarinë e tij elektronike, ku njihet me rezultatet e provimeve. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit. Doc 48.b Manuali i përdorimit të Portali Studentor për Administrim</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e</p>	<p>Refeuar modelit të tezës në dokumentacionin e përcjellë konstatohet se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale vlerësohet vetëm nga personeli akademik që jep lëndën, ndërsa kur lënda zhvillohet nga dy ose më shumë</p>

<p>provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>module testimi kryhet nga dy ose më shumë presonel akademik. Çdo formë e mundshme e kopjimit, ose mashtrimin nga ana e studentit gjatë provimit ndëshkohet me përjashtimin e tij nga provimi dhe shpalljen ngelës për sezonin në fjalë.</p> <p><i>Doc 7. Rregullore e prog. stud Bsc.MTRE</i></p> <p><i>Doc 14.c.3 Model teze provimi final, e firmosur</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Bsc në MTRE dhe në rregulloren e njësisë kryesore që administron dhe zhvillon këtë program studimi shprehet se, “provimet përfundimtare me shkrim sekretohen nga punonjësit e sekretarisë mësimore për të ruajtur anonimatën e studentit në procesin e vlerësimit”.</p> <p>Provimet hapen pas korigjimit dhe vlerësimit nga personeli akademik (një ose disa), në një seancë të dedikuar për këtë qëllim brenda pesë ditëve që nga kryerja e provimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që një praktikë të tillë të zbatohet edhe për provimin ndërmjetës, në mënyrë që i gjithë procesi i kontrollit të dijeve të jetë i monitoruar.</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga RVB marrim informacion që vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohen me komente/feedback dhe këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin në përmirësimin profesional. Për këtë në orën mësimore përpara zhvillimit të provimit përfundimtar kryhet një përmbledhje e temave dhe koncepteve të mara në lëndë. Po në këtë orë studentëve u zgjidhet një model testi duke ju sqaruar sistemi dhe menyra e vlerësimit të pyetjeve. Personeli akademik përgjegjës për lëndën apo modulën është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Në takimin që pati GVJ me studentët në ditët e vizitës në institucion kryerja e kësaj praktike u konfirmua prej tyre. Gjithashtu studentët u shprehën të kënaqur dhe të facilituar nga zbatimi i kësaj praktike.</p> <p><i>Doc 7. Rregullore e prog. stud. Bsc.MTRE;</i></p> <p><i>Doc 6a. Rregullore e njësisë kryesore;</i></p> <p><i>Doc 6b. Reg.Dept. Turizmit, Mikëpritjes dhe Rekreacionit;</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet dokumentit “Kodi i Etikës” së UniBA, rregullores së njësisë kryesore dhe rregullores së programit të studimit Bsc në MTRE garanton shmangien e plagjiaturës, kopjimin në provime e detyra. Sipas <i>Kreut II, Nenit 4, pika 6</i> në dokumentin “Kodi i Etikës” shmangie e plagjiaturës është një prej 11 parimeve të këtij kodi. Në nenin 111 të rregullores së UniBa specifikohen veprimet që përbëjnë shkelje të rregullave</p>


	<p>në UniBa ku plagjatura dhe kopja konsiderohen si të tilla. Rregullorja e programit të studimit në kreun e “masa disiplinore” përcakton konkretisht se studenti i nënshtrohet marjes së masave nga vërejtje me shkrim deri në përshtim nga shkolla nëse kryen plagjaturë, kopje gjatë procesit të provimit dhe detyrave.</p> <p><i>Doc 7. Rregullore e prog. stud. Bsc.MTRE.</i> <i>Doc 5. Rregullore e Universitetit Barleti</i> <i>Doc 5a. Kodi I Etikës</i></p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët kanë të drejtën e rishikimit të tezës së korrigjuar dhe bazuar në rregulloren e UniBa, gjithashtu kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Studentit i bëhet transparencë e vlerësimit të provimit përpara se pedagogu të hedhë rezultatin në proses verbal. Pas transparencës dhe dakortësimit për vlerësim pedagogu kryen hedhjen e rezultateve në procesverbal.</p> <p><i>Doc 7. Rregullore e prog. stud. Bsc.MTRE.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në rast se ndaj studentit janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë, ankesa bëhet me shkrim brenda 48 orëve dhe i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit, i cili përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës.</p> <p><i>Doc 5. Rregullore e Universitetit Barleti;</i> <i>Doc 7. Rregullore e prog. stud. Bsc.MTRE;</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Kur përgjegjësi i departamentit e konsideron të pamundur zgjidhjen e ankesës i drejtohet Dekanit. Ky i fundit brenda 48 orëve ngrë një komision ad hoc për verifikimin e ankesës. Me miratimin e Dekanit komisioni i ngritur përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit dhe nëse e gjykon mund të vendosë për përsëritjen e tij me miratim të Dekanit. Në takimet me studentët nuk na u paraqitën raste të ankimimeve, ata u shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real, gjithësesi ata janë në dijeni të rregullores dhe të drejtës së tyre për ankimim. <i>(Takimi me studentë)</i></p> <p><i>Doc 5 Rregullore e Universitetit Barleti,</i> <i>Doc 7. Rregullore e prog. stud. Bsc.MTRE.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit Bsc. Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente, është i organizuar sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi dhe i aftë që të thellojë dhe të zhvillojë aftësitë profesionale në dy fusha, histori dhe gjeografi.</p> <p>Programi i studimit Bsc. Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente zhvillohet në 3 vite akademike me 6 semestra dhe ka 180 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore = 50 minuta (<i>në praktikë ishte 50, në rregulloren e studimit 60</i>), 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika.</p> <p><i>Doc 7. Rregullore e prog. stud. Bsc.MTRE</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e objektivave si dhe pajisjen e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit. Disa prej këtyre lëndëve që e mundësojnë komunikimin dhe ndërveprimin janë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Gjuhë e huaj;2. Teknologji informacioni;3. Historia dhe Filozofia e rekreacionit; <p>Dijet e marra, aftësitë dhe kompetencat e përfituara gjatë realizimit të programit të studimit vlerësohen në përfundimin e lëndëve përkatëse me sistemin e notave ku nota 5 është nota minimale kaluese dhe 10 është nota maksimale.</p> <p><i>Doc 7. Rregullore e prog. stud. Bsc.MTRE</i></p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	<p>Dijet e marra, aftësitë dhe kompetencat e përfituara gjatë realizimit të programit të studimit vlerësohen në përfundimin e lëndëve përkatëse me sistemin e notave ku nota 5 është nota minimale kaluese dhe 10 është nota maksimale.</p> <p><i>Doc 7. Rregullore e prog. stud. Bsc.MTRE</i></p> <p><i>Doc 19.a Programi i Lëndës Teknologji Informacioni</i></p> <p><i>Doc 19.c. Programi i lëndës Historia dhe Filozofia e rekreacionit</i></p>



<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik stafi akademik paraqet në departament syllabusin e lëndës përkatëse në të cilin janë reflektuar përveç te tjerave dhe vërejtje apo sugjerime të studentëve. Në takimet në institucion na u theksua (<i>pasi si mendim është dhe në RVB</i>) që stafi ka marrë sugjerime shumë të vlefshme nga studentët që tashmë janë në tregun e punës. Në përfundim të modulit/lëndës, pedagogu organizon një përmbledhje të temave dhe çështjeve të diskutuara dhe orienton studentët për provimin përfundimtar, mënyrën e organizimit të tij dhe vlerësimit të dijeve.</p> <p><i>Vizita në institucion, Takimi me studentë</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti ka krijuar një përvijë të tijën, të organizimit të seminareve tryezave të rumbullakta të përbashkëta student/pedagog, dhe të ftuar. Tematikat e ketyre veprimtarive shkencore lidhen me jubile të ngjarjeve a figurave historike, me çështje të ndryshme aktuale (si çështje trashëgiminë kulturore, bashkepunimi ndërkufitar, probleme demografike, etj) në të cilat rihen mendime e ide, propozohen e rekomandohen veprimeve konkrete. Keto aktivitete kanë patur një impakt të lartë te studentët.</p> <p><i>Doc 38c. Aktivitete nga DTMR 2018-2021;</i> <i>Dokumente shitesë 9. Lisat e të stafit të ftuar gjatë dy viteve të fundit,</i> <i>Doc 8. Analiza vjetore e departamentit,</i> <i>Doc 7. Lista e aktiviteteve të departamentit + Plani I veprimt 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në programin Bsc. në “Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente” janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvijë në mësimdhënie. Pjesa më e madhe e stafit akademik (<i>sidomos në lëndët karakterizuese të kategorisë B, ku është dhe përqëndrimi më i madh i lëndëve</i>), janë specialistë të mirëfilltë të disiplinave të përkatëse (<i>të gjithë Doktor</i>).</p> <p>Programi i studimit në bazë të legjislacionit në fuqi ka një ndërthurje midis punës në auditor dhe punës individuale të studentit jashtë auditorit. Kurrikula e programit të studimit Bsc MTRE, reflekton një raport midis teorisë dhe praktikës në favor të orëve të praktikës. Dhe orët e studimit në auditor me ato të studimit individual, janë 1428 orë në auditor kundrejt 3072 orë praktike. Kjo tregon se studentëve u jepet më shumë mundësi mundësi për të praktikuar aftësitë e synuara. Stafi akademik ka marrë pjesë në disa aktivitete shkencore ndërkombëtare dhe bazuar në këtë përvijë por edhe në traditën e UK, format e mësimdhënes janë të</p>




	përafërta apo gati të njëjta me institucione apo programe si motra. <i>Doc 6. Plani mësimor i përditësuar sipas kërkesave të ekspertëve</i>			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Nga shqyrtimi i dokumentit RVB tregohet se puna në grup përdoret shumë si teknik në procesin e mësim dhënies në UniBA duke u konsideruar si një kontakt social i nevojshëm për studentët në veçanëti për studentët e viteve të para, me qëllim zhvillimin e aftësive intelektuale si, të dëgjuarit të folurit, të bashkëbisedimit, të drejtimit. Zgjidhja e problematikave të hasura nga diskutimi në grup është e vlerësueshme nga studentët.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Stafi inkurajon studentët të zhvillojnë ide dhe ti bëjnë ato të zbatueshme për profesionin e tyre në fushën e turizmit dhe rekreacionit. Gjatë takimit me studentët në vizitën në institucion GJV u njoh me disa përpjekje të tyre veçanërisht në hartimin e guidave në mënyrë specifike, guida e hartuara dhe e zbatuar nga studentja Çeleste Çerpja për zonat e Plavës dhe Gucisë dhe përpjekjet etjera në fushën e organizimit të eventeve. <i>vizita në institucion</i>			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	UniBa mbështet zhvillimin e ideve innovative tek studentët. Kjo tregohet nga pjesamrja e tyre në konkurset e start up-ve të organizuara nga bashkëpunimi me GIZ-Albania, BetaHOUSE Berlin, Creative Business Netëork Europe. UniBA dhe BetaHOUSE Berlin mundësojnë një biletë për fituesin e Betapitch Global in Berlin. Studentët e programit të studimit MTRE përfshihen në zbatimin e projekteve të fituara nga UniBa. Konkretisht ata janë përfshirë në projektin “Smart Travel on Cultural Routes”. <i>Doc 43a. Projekte të zbatuara dhe në process të Grupit Barleti</i> <i>Doc 43f. Lista e konkueseve në mbështetje të siprmarrjeve rionore</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik bashkëpunon me institucionet kryesisht jopublike vendase por edhe të huaja, për të mundësuar mobilitetin e studentëve. Për relizimin e shkëmbimeve studentore UniBa bashkëpunon me universitetin Politeknik të Barit, Itali, Universitetin e Viko-osë e Katalunjas në Spanjë, Universita degli studi di Genoa në Itali etj. <i>Doc 43c. të dhëna për mobilitetin e stafit dhe studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>UniBa ka hartuar dhe zbaton procedurë të posaçme për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës. Sipas rregullores së programit të studimit është vendosur një prag për studentët që mund të klasifikohen për mbrojtje të diplomës. Ajo është mesatarja jo më e ulët se 9.5 pikë. Për këdo student që arrin në përfundim të tre viteve mesatren 9.5 mund të kryejë mbrojtjen e diplomës. Për zhvillimin e provimit përfundimtar apo mbrojtjes së diplomës ngrihet një komision i cili ka jo më pak se tri anëtarë të departamentit dhe miratohet nga dekani i fakultetit. Vendimi përcillet sekretarisë për njohje dhe përgatitjen e listës së studentëve që kualifikohen për mbrojtjen e diplomës. Në dokumentin program për provimin e formimit jepen se cilat janë lëndët që do të përdoren për realizimin e provimit nga viti I, II, III dhe përcaktohen nëntemat përkatëse.</p> <p>GVJ konstaton se nuk ka një rregullore të posaçme për këtë proces të rëndësishm përmbyllës, ku të përshkruhen të gjitha hapat dhe detyrimet e palëve për këtë proces.</p> <p><i>Lidhur me këtë GVJ rekomandon që hapat për procedurën e provimit dhe mbrojtjes së diplomës të jenë të parashikuara në një rregullore të posaçme.</i></p> <p>Doc 14e. Programi për provimin e formimit në MTRE</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Departamenti i TMR është struktura përgjegjëse që asiston studentët duke i vënë në dispozicion materiale të nevojshme në funksion të provimit final të mbrojtjes së diplomës. Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është të lehtësojë studentët në rifreskimin e njohurive të marra dhe përgatisë ata për provimin final. Doc 14d. Programi për provimin e formimit në MTRE</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të</p>	<p>Në dokumentin program për provimin e formimit jepen se cilat janë lëndët që do të përdoren për realizimin e provimit nga viti I, II, III, përcaktohen nëntemat përkatëse dhe literatura që do të shfrytëzohet për përgatitje.</p> <p>Doc 14d. Programi për provimin e formimit në MTRE</p>

rëndësisë dhe peshës specifike.	
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Për realizimin e provimit final ose diplomës, DMTR vepron në përputhje me rregulloren e programit të studimit Bsc. "Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente", <i>Doc 7. Rregullore e prog. stud. Bsc.MTRE. takimi me studentë.</i> Diplomimi i studentëve të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente", realizohet nëpërmjet mbrojtjes së provimit të formimit, ose nëpërmjet mbrojtjes së një teme diplome. Departamenti përgatit fondin e pyetjeve të provimit të formimit dhe e vë atë në dispozicion të studentëve gjatë semestrit të pestë të studimeve. <i>Doc Fondi i pyetjeve të provimit të formimit</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Fondi përfshin pyetje nga lëndët bazë e karakterizuese: Bazat e Menaxhimit, Hyrje në Industrinë e turizmit, Parimet e Menaxhimit të Eventeve, Baza Turizmi (Viti I), Turizmi i Qyteteve dhe Zhvillimeve Urbane (Viti II), Turizmi i Trashëgimisë (Viti I III). <i>Doc 14d. Program për provimin e formit në MTRE.</i> Mbi bazën e tyre, komisioni i ngritur për këtë qëllim harton tezën e provimit të formimit, e cila miratohet nga Dekani. Teza e provimit përmban 67 pyetje me alternative <i>Doc 14c.3 Model teze e provimit final, e firmosur</i> , që synojnë vlerësimin e njohurive formuese dhe profesionale të studentëve. Departamenti harton listën e fushave prioritare të kërkimit dhe miraton temat e përzgjedhura nga studentët si dhe listën e pedagogëve udhëheqës brenda muajit nëntor të çdo viti akademik. Këtë e bën mbi bazën e propozimeve të miratuara të studentëve. Ai gjithashtu vë në dispozicion të studentëve manualin për punimin e temës të diplomës. <i>Vizita në institucion, takimi me personelin akademik të DTMR</i>
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Personeli akademik i caktuar në detyrën e udhëheqësit shkencor, bazuar në cilësimet e përcaktuara në manual, udhëzon, sugjeron dhe vë në dispozicion të studentit material bazë dhe plotësues me synim mbarëvajtjen e procesit të punës studimore të kryer prej tij. Pedagogu udhëheqës ndihmon dhe orienton studentin në punën hulumtuese, në hartimin e pyetësorëve dhe përpunimin e rezultateve, në kryerjen e intervistave apo vëzhgimeve në shërbim të temës së studimit.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	



Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.

Provimi i formimit mbrohet përpara një komisioni të përbërë nga 5 antarë. Vlerësimi bëhet me notë, që është mesatarja e vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit, menjëherë pas përfundimit të provimit. Në rastet kur aplikohet përfundimi i studimeve me mbrojtjen e temës së diplomës, udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Studentëve u ofrohet asistencë për sqarimin dhe saktësimin e detajeve të programit, apo u ofrohen konsultime dhe ju vihen në dispozicion materiale shtesë në funksion të përgatitjes së tyre për provimin e formimit. Në përfundim të studimeve, bazuar në legjislacionin në fuqi, por edhe në rregulloren e UniBA, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS dhe e përgatit sipas kërkesave të hapësirës europiane të arsimit të lartë. Diploma është një dokument zyrtar i Universitetit Barleti.

Programi i plotë i tre viteve akademike, sipas rregullore, u jepet vetëm atyre studentëve që e kërkojnëzyrtarisht. Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet. Sekretaritë, informacionin për studentin e kanë të ruajtur në tre regjistra:

1. Regjistrin themeltar të studentëve;
2. Regjistrin e arritjeve akademike;
3. Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave;

GVJ bëri një kontroll të rastësishëm për disa studentë, krahasimi midis notës së marrë në procesverbal dhe notës së hedhur në regjistrin e arritjeve akademike dhe rezultoi korrekt.


Në çdo rast që mund të kërkohet informacion nga studenti, sekretaria i kishte gati dhe duke zbatuar procedurën dhe rregulloren, i jepte ato. *[takimi në institucion me sekretarinë mësimore].*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimorshkencor dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat e institucionit për angazhimin e personelit akademik janë dhënë për një periudhë kohore 3-vjeçare, respektivisht për vitet akademike:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. VA.2019-2020 2. VA.2020-2021 3. VA.2021-202 <p>Përgjatë vitit 2020-2021 në këtë program studimi janë angazhuar si personel akademik efektiv, përkatësisht 18 lektor, prej të cilëve: 1 Prof.As, 7 Dr dhe 10 Msc. Ndërsa personeli akademik me kontratë i angazhuar në këtë program përfaqësohet nga 2 lektorë, 1 Dr dhe 1Msc. Departamenti i DTMRE nuk ka të punësuar personel ndihmës akademik.</p> <p>Nga të dhënat GVJ konstaton se, numri i personelit akademik efektiv ka ardhur në rritje. Gjithashtu në të dhënat e vëna në dispozicion nga institucioni jepet informacion edhe për angazhimin në procesin e mësimdhënies së çdo anëtri të DHGJ sipas semestrave dhe vitit akademik. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik si me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ishin të plota. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij program studimi.</p> <p><i>Stafi i Fakultetit, departamentit dhe të angazhuar në programin e studimit.</i></p> <p><i>Doc 38e. Analiza e dep, mbi arritjet e objektivave 2020-021, dokumentet shtesë-8. Analizë vjetore e departamentit</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UniBa ka një procedurë të përcaktuar për rekrutimin e personelit akademik. Ajo pasqyrohet në dokumentin “Manualin e menaxhimit të BurrimeveNjerëzore”. Në këtë praktikë përcaktohen:</p>



	<p>a. Shpallja para fillimit të vitit të ri akademik në faqen zyrtare të internetit të UniBa, në seksionin burimet njerëzore/ shpallje për pozicion të lire;</p> <p>b. Kriteret e përgjithëshme për aplikim;</p> <p>c. Dokumentet e përgjithëshme për aplikim;</p> <p>d. Gjenerimi i listës së aplikantëve;</p> <p>e. Vlerësimi paraprak i aplikantëve;</p> <p>f. Intervista;</p> <p>g. Vendimi për aplikantin fitues;</p> <p>h. Njoftimi i aplikantit fitues;</p> <p>i. Njohja me kushtet e kontratës dhe oferta financiare;</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në takim me Drejtorin e Zyrës së Burimeve njerëzore, u shpjegua që kriteret për rekrutimin e stafit propozoheshin nga DMTRE dhe kalojnë në zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Pas marrjes së konfirmimit nga Sekretari i Përgjithshëm vendi i lirë publikohet në faqen zyrtare të UniBa. Shpallja para fillimit të vitit të ri akademik në faqen zyrtare të internetit të UniBa, në seksionin burimet njerëzore/ shpallje për pozicion të lirë. GVJ kreu kontrollin e një praktike të rastësishme dhe konkludoi që praktika ishte korrekte në përputhje me deklaratimet e dokumentacionit dhe deklaratimit të drejtuesit të BNJ në UniBa.</p> <p><i>Doc 11. Manual i menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Departamenti evidenton nevojat për personel akademik dhe i paraqet ato në mënyrë të specifikuar Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Pas miratimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Grupit Barleti shpalljet kryen edhe në faqen zyrtare të UniBa në faqen zyrtare të këtij institucioni dhe në rrjetet sociale.</p> <p><i>Doc 11. Manual i menaxhimit të Burimeve Njerëzore; RVB dhe Takimi me Drejtuesin e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,</p>	<p>Institucioni realizon vlerësim dhe përzgjedhje të personelit mbështetur në procedurën me katër faza.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në fazën e parë, kryhet shpallja e pozicionit të lirë të punës; 2. Në fazën e dytë vlerësimi me dosje duke krijuar një databazë të aplikantëve;

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

3. Në fazën e tretë kryhet vlerësimi paraprak i aplikantëve nga një komision i përbërë nga Administratori, Sekretari i përgjithshëm, Drejtuesi i zyrës së mmenaxhimit dhe Administrimit të performances;
4. Në fazën e katërt intervista e ndarë në dy faza;
 - takimi paraprak;
 - intervista nga komisioni, intervista me gojë në prani të komisionit të ngritur;

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë:

Kritere të përgjithshme;

- Të ketë përfunduar studimet universitare në fushën përkatëse, sipas notës mesatare të përcaktuar në aktet ligjore;
- Të ketë diplomë Master i Shkencave në fushën e kërkuar me notë mesatare të përcaktuar në aktet ligjore;
- Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të mbrojtur dhe vërtetuar me dëshmi nga UT ose institucione të njohura ndërkombëtare;
- Të ketë të paktën 1 vit përvojë pune ose në mësimdhënien univeristare në fushën që do të mbulojë;
- Të ketë të dokumentuar veprimtari kërkimore shkencore të fushës përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Strukturat përgjegjëse në institucion zhvillojnë procedurën duke iu përmbajtur nevojave për staf akademik sipas profileve të kërkuara nga njësitë bazë. GVJ konstatoi në kontrollin e dosjeve të aplikantëve që këto kritere zbatoheshin me korrektësi.


Doc 11. Manual i menaxhimit të Burimeve Njerëzore;

Takimi me Drejtuesin e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore;

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.2

53



Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Universiteti ka mjedis të përshtatshëm për realizimin e detyrave të personelit. Ambjentet e punës janë të paisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave nga ana e personelit akademik. Në fondin e bibliotekës së UniBa gjendet një fond i dedikuar vetëm për fushën ku zhvillohet programi Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente me autorë kryesisht shqiptarë. Titujt e librave janë të rekomanduar nga personeli akademik që punon për programin e studimit Bch në MTRE. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh konkretisht me këtë fond dhe nga ballafaqimi konsatoi se titujt e librave janë në përputhje jo vetëm me dokumentacionin por edhe në përputhje me objektivat lëndorë të lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin e studimit.</p> <p><i>Krahas kësaj, GVJ konstatoi se titujt e librave në lëmin e Turizmit ishin të pakët në numër krahasuar me ato në lëmin e Menaxhimit të eventeve. Fondi reflektonte mungesë të titujve me autorë të huaj si në lëmin e turizmit ashtu edhe rekreacionit dhe të pesë viteve të fundit. Për këtë do të sygjerojmë shtimin e titujve me autorë të huaj dhe rifreskimin me botime të paktën të pesë viteve të fundit.</i></p> <p>Vizita në Institucion</p> <p>Doc 42c. Të dhëna për bibliotekën, MTRE;</p> <p>Doc 43g. Botimet e UniBa 3-5 vitet e fundit</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit tregoi se institucioni realizon disa nisma të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Stafi përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, mobilitete në kuadër të programit Erasmus + etj. Institucioni mbështet përmes skemës së financimit të kërkimit shkencor stafin akademik që realizon botime të artikujve shkencor të indeksuara në Sopus. Nga ballafaqimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion GVJ konstatoi se personeli akademik ka përfituar nga praktikat për trainimin e stafit nga program ERASMUS+ dhe vetëm 1 (një) here. Shkalla e përfshirjes në projekte është realizuar vetëm nga i gjithë personeli akademik me specializim në fushën e turizmit, rekreacionit dhe eventeve. Gjatë vizitës në institucion nga anëtarët e GVB u</p>

	<p>ngrit si shqetësim mos mbështetja financiare e institucionit të pjesmarrjes së stafit në ngjarje shkencore ndërkombëtare.</p> <p><i>Referuar gjetjeve, <u>GVJ sygjeron</u> që institucioni UniBa duhet të kontribuojë më shumë në mbështetjen financiare të punës kërkimore me qëllim nxitjen e personelit akademik në rritjen cilësore profesionale që do të reflektohet në të ardhmen në mësimdhënie cilësore dhe konkurruese.</i></p> <p>Doc. 43a. Projekte të zbatuara dhe në process të Grupit Barleti;</p> <p>Doc. 43c. të dhëna për mobilitetin e stafit dhe studentëve; Doc. 38.c Lista e aktiviteteve 2018-2021;</p> <p>Doc. 43d. Projekte të zbatuara dhe në Proces;</p> <p>Doc. 43e. Relacion mbi konferencën shkencore të organizuar nga DTMR;</p> <p>Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni realizon trajnime 1-ditore në bashkëpunim me Qendrën e Kërkimore të grupit Barleti me qëllim trajnimin për udhërrëfyesit turistik, për turizmin e aventurës. Gjithashtu marrja pjesë e stafit në programet Erasmus + krijon mundësi për të përfutur nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave inovative të mësimdhënies. Institucioni mundëson dhe trajnimin e stafit akademik nga zyra e Agjencia e Kërkimit dhe Teknologjisë së Informacionit, Zyra Erasmus + në Tiranë, etj.</p> <p>Doc 43a. Projekte të zbatuara dhe në process të Grupit Barleti;</p> <p>Doc 43c. të dhëna për mobilitetin e stafit dhe studentëve;</p> <p>Doc. 38.c Lista e aktiviteteve 2018-2021;</p> <p>Doc. 43d. Projekte të zbatuara dhe në Proces;</p> <p>Doc. 43e. Relacion mbi konferencën shkencore të organizuar nga DTMR;</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni dëshmon për përpjekje serioze për përmbushjen e objektivave në mbulimin e programit me staf akademik me tituj dhe grada shkencore. Përgjatë vitit 2020-2021 personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në program ka qënë: 1 Prof.As; 7 Dr; dhe 10 Msc, ndërsa si lektor me kontrate ka rekrutuar 1 me gradën Dr dhe 1 Msc. Formimi profesional i personelit akademik është në përputhje me përmbushjen e objektivave që programi i studimit Bsc në MTRE ka për të realizuar. Personeli akademik me tematikat e përzgjedhura për mbrojtjen e gradës shkencore Doktor përmbush kërkesat për një program cilësor të ciklit të parë BSC në MTRE.</p> <p>Gjatë takimit në institucion u informuam nga anëtarët e personelit akademik të DHGJ se, disa prej tyre kanë plotësuar dosjet për kërkimin e tituli Doktor dhe janë në pritje për ta</p>


	<p>fituar atë. Kjo dëshmon për përpjeket që ata bëjnë në rritjen e shkallës së profesionalizmi me qëllim për ti shërbyer më me cilësi zhvillimit të programit të studimi MTRE.</p> <p><i>Mbështetur në listën e lektorëve të ftuar <u>GVJ do të sygjeronte se krahas te ftuarëve që sjellin eksperiencia nga tereni departamenti të përfshinte edhe lektorë me tituj Prof. Dr dhe me përvojë akademike në fushën e turizmit për fuqizimin cilësor të programit dhe përballimin e konkureshmërisë nga programe të ngjajshme.</u></i></p> <p>Stafi I fakulteti, Departamentit të angazhuar në program [Vizita në institucion]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Turizmit, Mikëpritjes dhe Rekreacionit zhvillon procesin mësimor në mjediset e FSHTS, i cili ndodhet në mjediset e Kampusit 2 të UniBa. Kampusi 2 ku ndodhet godina e FSHTS ka sipërfaqe m²/njësi 2514 m² dhe ka në dispozicion 9 laboratorë në katin përdhe, të parë, të dytë dhe të tretë, 7 klasa, 1 laborator + klasë, të cilat shërbejnë për leksione dhe seminare. Klasat janë të paisura të gjitha me video projektorë po ashtu edhe sallat e Bibliotekave si ajo në holl dhe ajo shkencore. Nga vizita në instiucion grupi i GVJ konstaton se mjediset ishin të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e proceseve akademike. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në salla leksionesh dhe seminaresh të cilat plotësojnë realizimin e objektivave mësimorë në funksion të 6 studentëve që ka ky program. Studentët e programit “Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente” kanë patur në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për përmbushjen e realizimit si të orëve teorike ashtu edhe moduleve specifike.</p> <p>Vizita në institucion; RVB Dok. 42b Të dhëna për infrastrukturën;</p>

	Dok. 24c Të dhëna për bibliotekën;
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në UniBa, mjediset mësimore ku zhvillonin procesin mësimor studentët e programit Bsc “Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente” garantonin realizimin e procesit mësimor. Ato janë të paisur me smartboard dhe sistemem projektimi digjital, përfshirë edhe të gjitha mjetet e tjera audio dhe video. Laboratorët janë të paisur me kompjutera, priter/fotokopje/skaner, projektor. Institucioni ka një numër të konsiderueshëm laboratorësh. Dok. 42a Raporti i ekspertit për infrastrukturën Vizita në institucion
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Dokumentacioni argumentues që shoqëron RVB tregon se institucioni ka një numër të madh laboratorësh janë të paisur me kompjutera, priter/fotokopje/skaner, projektor, por nuk specifikohet nese ka një të dedikuar fushës ku zhvillohet programi i studimit MTRE. <u>GVJ rekomandon që të ketë edhe një laborator të dedikuar për fushën e turizmit duke qenë se kjo fushë nga drejtuesit e institucionit konsiderohet prioritet për këtë institucion.</u> Vizita në institucion Dok. 42a Raporti i ekspertit për infrastrukturën, RVB
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, për studentët dhe stafin akademik. Për realizimin e detyrave të studentëve të programit MTRE bashkëpunohet edhe me tri laboratorët e teknologjisë së informacionit, të cilët e mbështesnin fort këtë program studimi. Vizita në Institucion
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Referuar RVB, kapacitetet e UniBa dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. Mjediset mësimore si klasa, auditorë e laboratorë mundësojnë realizimin e procesit mësimor. Nga vëzhgimi i drejtëpërdrejtë i auditorëve, laboratorëve, programeve të reja kompjuterike, bibliotekës gjatë vizitës u konstatua se mjediset mësimore dhe ato ndjhmëse janë të pajisura me lidhje interneti dhe me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit duke siguruar përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies/mësimnxënies në varësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimoretëorik dhe praktik mësimor. Vizita në institucion

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në nivel universiteti, UniBA vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën Universitare në dy Kampuset 1 dhe 2. Biblioteka e FSHTS garanton të drejtën e çdo studenti për, aksesim të bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe ambjenteve të mjediseve të brendshme dhe të jashtëme të saj. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i të gjithë hapsirës së bibliotekës me rrjetin Wireless dhe të aksesohen në biblioteka on-line.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka që është në shërbim të programit të studimit Bsc në MTRE, e ka njësinë qendrore në katin e përë me sipërfaqe 27.3 m ² dhe ka 5 .250 tituj dhe 18 vende leximi dhe ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online. Po brenda Kampusit 2 biblioteka zgjerohet në katin përdhe në një tjetër hapësirë prej 95.1 m ² me 50 vende leximi. Kjo njësi është e paisur më revista shkencore, punime të konferencave, periodike të fushës së turizmit, rekreacionit dhe menaxhimit të eventeve. Gjatë vizitës GVJ u njoh konkretisht me fondin e titujve të librave në shërbim të programit të studimit. <i>Bazuar në këtë vizitë GVJ rekomandon shtimin e titujve të librave në gjuhë të huaj të pesë viteve të fundit.</i> <i>Dok. 42c. Të dhëna për bibliotekën, MTRE</i> <i>RVB</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Referuar RVB, UniBa krijon kushte për akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët e programit MTRE në bibliotekat on-line. Gjatë vizitës në institucion punonjësja e bibliotekës konfirmoi duke na stimuluar një rast konkret për akses në këto biblioteka. <i>Vizita në Insitucion;</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe	Biblioteka në Kapusin 2 ku edhe zhvillohet program i studimit Bsc në MTRE ka një fond prej librash me karakter revista



<p>kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>shkencore, punimet e konferencave, periodikë të fushave të ndryshme dhe 50 poste leximi dhe poste me kompjutera për ofrimin dhe aksesimin e bibliotekës digjitale të universitetit dhe të bibliotekave on-line ndërkombëtare si, Econ Biz, Research4life, Hinari, AGORA, OARE, ARDI, JTSOR, GOALI. Të gjithë studentët e këtij program janë anëtarë të bibliotekës. Menaxhimi i bibliotekës kryhet nëpërmjet platformës on-line Për shkak të pandemisë, UniBa ka shfrytëzuar qasjen në biblioteka digjitale, duke u ofruar punonjësve dhe studentëve të tij falas gamën e gjerë të librave në bibliotekat elektronike.</p> <p><i>Dok. 42c. Të dhëna për bibliotekën;</i> <i>Dok. 45. Lisat e teksteve në bibliotekë-MTRE;</i> <i>Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>UniBa ndjek një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës sipas kërkesave që vinë nga njësitë bazë. Përgjegjësit e programit të studimit përmes kërkesave të marra nga personeli akademik me titujt e propozuar i përcjellin ato bibliotekës së UniBa. Nga takimi që patëm me punonjësen e bibliotekës na u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsiderat kërkesat e stafit akademik dhe realizimi i procedurës për pasurimin e fondit realizohet në mënyrë periodike.</p> <p><i>RVB;</i> <i>Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 8.00-16.00. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët kishin mundësinë të tërheqin literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shfrytëzonin bibliotekën gjatë hapsirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UniBa ka hartuar një udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit. Ky dokument është në funksion të menaxhimit të të dhënave, komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe gjithë procedurat rregullat dhe politikat përkatëse, ai përmban çështje si Portali Studentor, Sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentëve SIS Classter, Google Classroom, Intranet dhe GSuit për komunikim të brendshëm, Webfaqja zyrtare e UniBa dhe nënfaqet e grupit Barleti. Sistemi mundëson informimin në kohë reale të studentëve lidhur me rezultatet e tyre dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën për të gjithë procesin. Në kushtet konkrete të ndërprerjes disa mujore të mësimin në auditor, realizimi i mësimin online është mundësuar nëpërmjet platformave të ndryshme. U përdorën gjerësisht gjatë vitit akademik 2019 – 2020 platformat Google Classroom, Skype dhe Hangout Meet. Gjithashtu është konstatuar se institucioni ka hartuar një dokument në formën e një guide instructive për mbështetjen dhe pasurimin e mësimin on-line gjatë periudhës së pandemisë.</p> <p><i>Dok. 46. Udhëzues për përdorimin e strukturës së TIK.</i></p> <p><i>Dok. 48.a Manual i përdorimit të Google Classroom për pedagogët</i></p> <p><i>Dok. 48.b Manual i përdorimit të Portalit Studentor për administrim</i></p> <p><i>Dok. 48.c Manual i përdorimit të Google Classroom për studentët</i></p> <p><i>Dok. 48.d Manual i përdorimit të GSuit</i></p> <p><i>Dok. 48.e Manual i përdorimit të Intranet</i></p> <p><i>Dok. 48. Manual i përdorimit të SIS Classter për studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi Intranet mundëso komunikimin e brendshëm, informacionin dhe materialet që lidhen me procesin mësimor ndërmjet stafit akademik dhe studentëve në kohë reale. Ky sistem mundëson lehtësira si për studentët pasi ata informohen mbi rezultatet e testimit, njoftime, materialet e lëndëve etj ashtu edhe për stafin akademik që dokumenton punën e tij përmes sistemit. Një tjetër aspekt i rëndësishëm që menaxhohet dhe administrohet nga ky system është dhe veprimtaria e sekretarisë mësimore duke plotësuar</p>

	<p>bashkëpunimin e të tre komponentëve Student/sekretari mësimore/personel akademik.</p> <p>Dok. 48.e Manual i përdorimit të Intranet;</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UniBa përmes sistemit të menaxhimit që përdorë, në bazë të programeve të studimit mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët. Përmes sistemit G Suit, Intranet institucioni mundëson dokumentacionin dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit. Përdormi në nivel institucional i këtij sistemi mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik. Gjatë vizitës në institucion GVJ konsatoi se format e mbështetjes së sistemit për personelin akademik ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Publikimi online i kurrikulës së programit të studimit; 2. Monitorimi i planit mësimor; 3. Regjistrimi në sistem i personelit akademik përgjegjës për lëndën/modulin dhe atë ndihmës mësimor; 4. Raportimi mbi ecurinë e plotësimit të afateve të përcaktuara në Manual; <p>Format e mbështetjes për studentët ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ngarkimin e detyrave të kursit; 2. Ngarkimin e projekteve; 3. Marrjen e leksioneve të ngarkuara nga personeli akademik; 4. Marrjen e vlerësimeve; <p>Personeli ndihmës akademik ndihmon studentët duke ju vënë në dispozicion një sekretari online në kohë reale dhe nga çdo vend, për t'iu bërë të ditur:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grafikun e provimeve; 2. Notat e provimeve; 3. Lajmërime apo informacione të dërguara nga pedagogët apo departamenti; 4. Vërtetime të ndryshme; <p>Dok. 48.a Manual i përdorimit të Google Classroom për pedagogët;</p> <p>Dok. 48.b Manual i përdorimit të Portalit Studentor për administrim;</p> <p>Dok. 48.c Manual i përdorimit të Google Classroom për studentët;</p> <p>Dok. 48.e Manual i përdorimit të Intranet;</p> <p>Dok. 48. Manual i përdorimit të SIS Classter për studentët;</p> <p>Vizitës në sekretarinë mësimore</p>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në UniBa krahas sistemit Intranet është përdoruar edhe SIS Cluster. Ai ka krijuar mundësinë e komunikimit interaktiv dhe në kohë reale. Përmes kësaj platforme realizohen shkëmbime të informacionit midis stafit akademik dhe studentëve. Platforma Microsoft Team mundëson monitorimin e aktivitetit akademik nga strukturat e NJSBC-së dhe jo vetëm. Nëpërmjet kësaj platforme merren të dhëna dhe realizohen raporte mbi aktivitetin e përdorimit të saj nga anëtarët e personelit akademik.</p> <p><i>Dok. 48f1. Manual i përdorimit të SIS Cluster për studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të programit të studimit Bsc në MTRE, GVJ konstatoi se sistemi Portali Studentor kontrollon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Autenticitetin e informacionit identifikues të përdoruesit; ➤ Autorizon aksesin e përdoruesit në të gjitha funksionet/operacionet; ➤ Ruan privatësinë e të dhënave; <p>Nëpërmjet këtij sistemi institucioni mund të monitoroj në kohë reale aktivitetin mësimor të personelit akademik dhe administrativ. Me të dhënat reale të grumbulluara mund të hartohen raporte monitorimi rreth performancës së procesit mësimor si nga personeli akademik, ndihmës por edhe pjesmarrjes së studentëve në frekuentimin dhe zhvillimin e procesit mësimor. Të dhënat e grumbulluara iu vihen në dispozicion titullarëve të njësisë kryesore edhe të njësisë bazë. Nga databaza e krijuar krijohet një panoramë e qartë rreth hedhjes në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e kriterëve të vlerësimit dhe respektimin e afateve të hedhjes së rezultateve online. Sistemi Portali Studentor ka aksesin e tij nga faqja zyrtare e internetit të UNIKO.</p> <p><i>Dok.48b. Manuali i përdorimit të Portalit Studentor për administrim;</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ hyri në faqen e internetit të UniBa dhe konstatoi që ajo mund të konfirmojmë informacionin e kërkuar lidhur me gjuhën e hedhjes së informacionit në internet.</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni çdo vit. Ai kryhet nga zyrat e financës nën drejtimin e Administratorit të deleguar të UniBa. Raportet përmbajnë të dhëna të hollësishme për llogaritjen e kostove të programit MTRE dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi.</p> <p><i>Dok.49 Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional;</i> <i>Dok. 50, Të dhëna nga plani i financimit të programit;</i> <i>Dok. 50b Raport i adituesve të pvarur dhe pasqyra financiare 2019;</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Mbështetur në Planin e financimit të programit burimet e financimit të programit MTRE në UniBa janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsulencat, shërbimet; - Tarifa për dhe gjatë shkollimit; - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm); - Të tjera (qera, ndryshime të kursit valuator, interesa bankare); - Donacionet dhe projektet; <p>Në dokument paraqitet ecuria e këtyre zërave për vitet 2018, 2019, 2020. Nga të dhënat vihet re një rritje e treguesve të mësipër me të cilët justifikohet mbështetja financiare. Nga të dhënat GVJ konstaton se ka mungesë të informacionit nga ana e institucionit për masën e financimit të burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, të financimit për bibliotekën dhe pasurimin e saj, të vlerës së granteve vendëse apo të huaja, apo vlerën e kontratave të shërbimeve që lidhen me realizimin e programit të studimit. <i>Plani i financimit është sipërfaqësor dhe jo i dedikuar për programin e studimit por për nevojat e departamentit.</i></p> <p><i>Dok.48f1. Manual i përdorimit të SIS Cluster për studentët;</i></p>



<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Bazuar në RVB, UniBa kryen auditim të brendshëm periodik nga njësia e auditimit të brendshëm të këtij institucioni. Brenda dy javëve raporti paraprak i dorëzohet Administratorit, Raporti përfundimtar i dërgohet menaxhimit të institucionit. Krahas auditimit të brendshëm institucioni i nënshtrohet edhe një auditimi të jashtëm nga kompania Grant Thornton. Kjo kompani ndërkombëtare çertifikon pasqyra financiare.</p> <p><i>GVJ mbështetur në dokumentacionin mbështetës konstaton mangësi. Në listën e dokumentave mungojnë të dhëna të detajuara lidhur me të ardhurat e akumuluar dhe ndarjen e burimeve financiare, nu ka një raport specifik financiar.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Bazuar në RVB raportet përmbajnë transparencë përsa i takon kontabilizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në nivel institucioni raportet janë periodike, të përvitshme. Sikundër është theksuar dhe më lartë për këtë program studimi nuk ka një raport specifik financiar. <i>Institucioni paraqet pasqyrat ekonomiko financiare në bilanc por nuk paraqet të dhëna konkrete për planifikimin e ndërhyrjeve të posaçme të financimit të programit.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>UniBa si institucion jopublik i arsimit të lartë i siguron burimet e financimit nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsulencat, shërbimet; - Tarifa për dhe gjatë shkollimit; - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm); - Të tjera (qera, ndryshime të kursit valuator, interesa bankare); - Donacionet dhe projektet Referuar RVB UniBa siguroon qëndrueshmëri financiare për gjatëgjithë kohës që zhvillohet program i studimit MTRE; <p>GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të GVB dhe Stafin Akademik, u informua se politika e mbështetjes mundësohet nga qëndrueshmëria financiare dhe forma e menaxhimit të qëndëruar duke mundësuar shpërndarjen e kostove në nivel institucioni.</p> <p><i>Takimi në Institucion</i></p> <p><i>Dok.50. Të dhëna nga plani i financimit të programit;</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ky program studimi është ndertuar dhe bazuar në rregulloren e vet perkatese të programit të studimit, në rregulloren e universitetit, si dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë. Në rregulloren e këtij departamenti për programin e studimit përcaktohen qarte të gjitha njesitë dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre për mbarevajtjen e plote të këtij program studimi. Kjo rregullore i bashkëngjitet dokumentave të tjera të UniBa dhe i shërben edhe studentëve të këtij program studimi për t'u bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjatë të gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni. <i>(neni 2, efekti juridik)</i></p> <p>Në nenin 4 të rregullores së UniBa, thuhet se një ndër shtyllat e aktiviteteve kryesore është pikerisht studenti si një ndër 5 shtyllat kryesore të tij. Shtylla e studentit në qendër përfshin organizimin dhe bashkëpunimin e njesive të angazhuara në proceset në mbështetje të studentëve që nga njohja e tyre me UniBa deri tek pranimi, regjistrimi, angazhimi në jetën studentore dhe komunitare, mbështetja në përparimin profesional, dhe në karriere, etj. Përgjatë vizitës në institucion, një ndër pikat e axhendes të organizuar nga ASCAL, ishte edhe takimi me strukturat që janë në kontakt me studentet dhe informojnë ata që në hyrje të programit të studimit e deri në përfundim të ciklit të studimit bachelor. Institucioni ka një mireorganizimin dhe vëmendje përmes strukturave të ngritura për studentet që nga hyrja e deri në dalje. Konkretisht disa prej këtyre strukturave janë:</p> <p>Zv rektori për çeshjtet studentore i cili manaxhon disa zyra si Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, Dekanin e Studentëve dhe vet organizimin studentor dhe Zyren e Alumnit dhe të Karrierës. Nderkohe që një ndër parimet e funksionimit</p>

	<p>te UniBa e reflektuar edhe ne rregulloren e institucionit, te programit dhe dok e tjera shoqerues strategjik, lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat ne hyrje e deri ne dalje garantojne barazine dhe te drejta te njejta per te gjithë kandidatit per student te programit te studimit.</p> <p><i>Dok 53. Ligji nr 80/2015. Dhe VKM nr 41 dt 24.01.2018 te ndryshuar me VKM nr 879 dt 118.12.2019.</i></p> <p><i>Dok 5. Rregullore e Universiteti Barleti, neni 4, 9</i></p> <p><i>Dok 2. Statuti i Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Dok 7 Rregullore e programit bachelor MTRE</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p> <p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>E diskutuar edhe me studentet pergjate vizites ne institucion, dakortesohet se ekziston i aksesueshem i gjithë informacioni qe lidhet me te gjithë proceduren qe nga pranimi dhe përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, informacione keto qe janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Informacione te tilla si dhe kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve gjenden lehtësisht te aksesueshem ne faqen e internetit, behen me dije edhe fizikisht ne zyrat e pranimit dhe informimit te studenteve. Keto kriteret publikohen ne dokumenta te vencate sikurse behen me dije edhe ne faqen zyrtart t web te UniBa. Keto kriteret pranimit te studenteve e kane fillesen ne departamentin DMTRE i cili propozon dhe miratohen me vendim senati. Nderkohe qe heret, perpara fillimit te vitit akademik, universiteti permes strukturave te veta ve ne dispozicion te te interesuarve informacione te detajuara ne lidhje me kriteret e pergjithshme dhe specifike te regjistrimit ne programin e studimit Bsc ne "Manaxhim ne Turizem, Rekreacion dhe Evente". Shperndarja e ketij informacioni behet permes menyrove dhe rrugeve te komunikimit qe nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - broshurat, fletpalosjet; - publikimet ne rrjetet sociale; - por edhe ëeb zyrtar te UniBa; - ne ambientet fizike te institucionit; - si dhe permes mediave te ndryshme; <p><i>Dok 65 b Kriteret e pranimit te studenteve ne vitin akademik 2020 2021</i></p> <p><i>Dok 7 Rregullore e programit bachelor MTRE</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyruar GVJ konsatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime, sikurse dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>Keshtu studentet informohen ne lidhje edhe me njohjen e kualifikimeve te tyre te meparshme ose te kryera heret ne kohe, sikurse pranohen edhe transferime te studenteve nga institucione te tjera te arsimit te larte brenda dhe jashte vendit. E gjithë kjo procedure eshte e rregulluar me dokumentacion dhe parashikohet ne rregulloren e transferimeve, rregulloren e programit te studimeeve si dhe nga evidencat e Manual Rekrutimeve Aplikim Regjistrim Transferim. UniBa ka një rregullore mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin ku bazohet realizimi i procedurës dhe informimi i studentëve mbi këto procese. Gjithashtu, zyra ndaj kujdesit të studentit në bashkëpunim me departamentin dhe sekretarinë mësimore informojnë dhe lehtësojnë studentin me vlerësime paraprake për transferim studimesh apo njohje të tyre. Studentët mund të aksesojnë indormacion lidhur me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparëshme ose të pjesshme nëpërmjet faqes së ëeb-it të UniBa.</p> <p><i>Dok 65a Udhezim 54: Manual Rekrutimeve Aplikim Regjistrim Transferim</i></p> <p><i>Dok 65 B Vendim Senati Kriteret e pranimit te studenteve 2020 2021</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Informimi i studentëve lidhur me kriteret e proceduarat e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njëpërjet rregulloreve të programit të studimit; - Njëpërjet praktikës së informimit të studentëve të viti të parë të programit DMTR; - Njëpërjet syllabuseve lëndore që jepen nga personeli akademik në orën e parë të fillimit të çdo lënde; - Njëpërjet personelit akademik në fillim të çdo semestri; - Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen online nga studentët; <p>Gjithashtu, në lidhje me diplomimin eksizton një informacion i shprehur përmes <i>dok 65b</i>, ku prova finale kryhet përmes provimit të formimit dhe me punim diplome. Studentet me mesatare mbi 9.5 mund të përgatisin një punim diplome ndërsa studentet e tjere i nënshtrohen provimit të formimit, i cili përmban ceshtjet kryesore të të gjitha lendeve të programit mesimor përmes një database që lidhet vecanerisht me kompetencat kyce të formuara. GVJ konstaton se informimi i studentëve lidhur me procedurat e vlerësimit është i larmishëm dhe i shtrirë në disa plane. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me student në ditët e vizistës në institucion.</p> <p><i>Dok 65 b Kriteret e pranimit të studentëve në vitin akademik 2020 2021</i></p> <p><i>Dok 7 Rregullore e programit bachelor MTRE</i></p> <p><i>Dok 14 b Programi për provimin e formimit në programin MTRE</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Një ndër ceshtjet që u diskutua vecanerisht me stafin e këtij departamenti ishte nevoja për një marketing më të mirë të këtij programi në të ardhmen nga vete institucioni. Në këtë mënyrë do të mundet që maturantët të njihen më shumë me këtë program studimi për të mundësuar edhe rritjen e numrit të studentëve që në fakt përben një pikë të dobët ku duhet punuar ende në këtë drejtim. Numri i ulet i studentëve në këtë program studimi justifikohet nga stafi edhe me largimin e studentëve jashtë vendit, apo me ofrimin e programeve të ngjashme në gjuhën angleze si dhe konkurrenca nga universitete të tjera, sado që emertimi i këtij programi është unik sepse lidh dhe referon 3 fusha: turizmin, me rekreacionin dhe eventet.</p> <p><i>Dok 51. Strategjia e marketingut dhe e rekrutimit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.3


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Sipas statusit të këtij institucioni (<i>Dok 2 Statusi IAL</i>), brenda këtij institucioni janë ngritur disa njësi që janë përgjegjëse për mbarevajtjen e cilesise dhe kontrollit të performances si:</p> <ul style="list-style-type: none">- Njesia e zhvillimit të Kurikules dhe Cilesise (NJZHKC) me një drejtues dhe 3 kordinatorë;- Keshilli i Etikës dhe Shansëve të Barabarta;- Komisioni i Vlerësimit të Performances;- Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilesise; <p>Mundësitë e informimit fizik merren në institucion pranë disa zyra apo njësi që ofrojnë informacione për çdo program të detajuar që interesohet studenti. Në momentin që një student është i duazuar midis dy apo disa programeve të studimit, atëherë drejtuesi i departamentit dhe/ose kordinatori i departamentit i ofron informacione me të detajuara për programet e interesuara me qëllim që studenti të marrë informacione me të detajuara dhe të hollësishme të nevojshme për vendimmarrje. Përveç kësaj departamenti përgjegjës për ofrimin e këtij program studimi ka angazhuar edhe pedagogë me kohë të pjesshme duke u munduar të profilizojë ato me lëndet që japin mesim. Por së pari, është departamenti si njesia kryesore përgjegjëse e ofrimit të këtij program studimi e cila është përgjegjëse për mbarevajtjen e këtij programi, e kontrollon dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe reflekton përmes raporteve dhe analizave vjetore/periodike. Institucioni ka vendosur një procedurë e cila përfshin së pari departamentin që është përgjegjës për këtë program studimi, stafin që angazhohet në mesimdhënie me kohë të plote e të pjesshme përmes raporteve dhe informacioneve të dhëna nga to, sikurse dhe përmes njësi të tjera. Kështu, ngritja e strukturs Dekani i Studentit është një qasje mbështetëse dhe pozitive për studentin dhe për ta përfshirë jo vetëm në qasjet sociale të institucionit por edhe ato edukuese, mesimdhënëse të përditshme me të cilat përballen studentet.</p> <p>Portali SHLUJ është një sistem i rëndësishëm i konsideruar nga studentet ku ata mund të aksesojnë përmes kredencialeve private të tyre informacione mbi lëndet, kreditet, syllabuset</p>

	<p>etj. Nderkohe qe platforma google classroom perdoret per te hedhur leksione dhe materiale te ndryshme qe i takojne zhvillimit te leksioneve dhe seminareve. Kjo forme ka rezultuar eficente qe ne kohen e covid 19 dhe perdoret ende nga pedagoget dhe studentet si sistem i mire dhe efektiv komunikimi. Dok 7 Rregullore e programit bachelor MTRE</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët edhe përfaqësuesit e Qendrës së Karrierës dhe Alumni, GVJ u njoh me format e informimit që ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veprimtari informuese që organizon vetë departamenti; - Informim nga pedagogët; - Informim nga strukturat administrative në Rektorat; - Informacioni i marrë në faqen zyrtare të internetit; - Informacioni vihet në dispozicion të një publiku më të gjerë me anë të njoftimeve të zyrave të informimit apo Karrierës dhe Alumni në website-in zyrtar të UniBa për studentët e universitetit; <p>Të gjitha format e renditura u japin mundësi të barabartë të gjithë studentëve për të qenë të informuar. Gjithashtu mundësi të barabartë iu ofrohet edhe kandidatëve për student në këtë universitet nëpërmjet shpalljes së detyrueshme të listës së studentëve fitues në programin e studimit në stendën e njoftimeve të universitetit edhe në faqen zyrtare të UniBa. Studentet mund të përdorin edhe kredencialet e tyre individuale të umb.edu.al përmes portalit studentor studentportal.barleti.</p> <p>Dok 27. Manuali i mesimdhënieve online</p> <p>Dok 39 b. Guide instruktive për mbështetjen dhe pasurimin e mesimdhënieve online</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nok përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Institucioni ka vene ne dispozicion te GVJ statistika qe tregojne te dhena per numrin e studenteve aktuale per kater vitet e fundit akademike si me poshte:</p> <p>Per vitin akademik 2018-2019: 5 studente; Per vitin akdemik 2019 2020: 4 studente; Per vitin akademik 2020-2021: 8 studente; Per vitin 2021 2022: 3 studente;</p> <p>Nderkohe qe numri total i te diplomuarve eshte 3, numri i te punesuarve ne perputhje me diplomen eshte 2, dhe numri total i te punesuarve jo ne perputhje me diplomen eshte 1.</p> <p><i>Aneks me tabela. Tab 21 fq 21: Cilesia ne hyrje dhe ne dalje e studenteve</i></p> <p><i>Tabela 23, fq 22 Te dhena per diplomimin dhe punesimin e studenteve</i></p> <p><i>Dok 7 Rregullore e programit bachelor MTRE</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vunë në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që janë transferuar në këtë program studimi (në total 2 në dy vite). Institucioni disponon të dhëna vjetore për programin bachelor në “Manaxhim në Turizem, Rekreacion dhe Evente”. <i>Takimi në sekretarinë mësimore; RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit është konstatuar se institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin. Në analizën vjetore të departamentit të DMTRE trajtohet në mënyrë të veçantë numri i studentëve të regjistruar sipas programeve të studimit, numri i studentëve përsëritës, kalueshmëria dhe nota mesatre e të diplomuarëve.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Zyra përgjegjëse për disponibilitetin e të dhënave është sekretaria mesimore e cila mban të dhënat e studenteve në regjistrin e të dhënave akademike, të cilat gjenden njëkohsisht edhe në formë elektronike. Nderkohe portali studentor përben një format elektronik të të dhënave të perdorur jo vetëm nga studentet por edhe sekretaria që në çdo kohë ka akses për të hedhur notat dhe rezultatet e provimeve, datat përkatëse të zhvillimit të provimeve dhe kalendarin e provimeve, etj. Nderkohe që ky portal shërben si burim</p>



	rekord informimi per studentet per vleresimet e tyre akademike. <i>Dok 48 b Portali studentor</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Institucioni ka ndertuar tabela te perfshira ne aneksin e tabelave me informacione ne lidhje me cilesine ne hyrje dhe dalje te studenteve, ku reflektohet jo vetem nr i studenteve te regjistruar per cdo vit akademik qe nga 2018 2019 si vit i pare i lancimit te ketij programi, por edhe mesataret perkatese te studenteve, numrin e transferimeve brenda ketij program studimi, numrin e te diplomuarve si dhe ato te diplomuar sipas ose jo profilit te diplomes. Nderkohe qe edhe vete departamenti e perfshin kete ceshtje te raporteve analitike te studenteve ne raportimet vjetore te tyre, ndersa zyra e karieres i mundeson dhe ofron pergjate te gjithë kohes studenteve mundesi punesimi te ndryshme. Mbi bazen e ketij komunikimi qe zhvillohet alumni me tej, perditesohet edhe Bordi i Karieres prane Departamentit DMTRE.</p> <p><i>Dok 7 Rregullore e programit bachelor MTRE</i></p> <p><i>Dok 38e. Analiza e Departamentit DMTRE vjetore periodike mbi arritjet e objektivave formuese te programit te studimit dhe rezultatet te pritshme te te nxenit dhe te aftesimit profesional (2020 2021)</i></p> <p><i>Dok 33 tabele permbledhese per trainimet profesionale me student MTRE</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Studentet jane te perfshire ne forma te ndryshme ne kete program studimi. Pervec pasjes se nje Dekani posacerisht per ta, u mundesohet midis te tjerave edhe nje jete sociale ne komunitet me e gjere.

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.

Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.

Nga takimi ne institucione me grupin e studenteve u qartësua se per problematika, vendimarrje apo rradhe te ndjekjes se procedurave perkatese eshte:

- Studentet fillimisht i percjellin senatoreve se tyre shqetesimin apo informacionin;
- Senatorja ia percjell shefit te departamentit dhe me tej dekanit te studenteve.

Studentet ftohen te japin opinionet e tyre, dhe njesia e sigurimit te cilesise 2 here ne vit mbledh opinionet e studenteve per secilen lende dhe secilin pedagog. Studentet jane te perfaqesuar edhe me nje anetar ne hartimin e raportit te vleresimit te brendshem te ketij program studimi. Ne sugjerimet e propozuara dhe te dakortesuara pergjate vizites ne instiutcion me stafin akademik dhe drejtuesin e departamentit u dakortesua per permiresimet e mundshme te planit mesimor ne perputhje dhe mbeshtetje te rritjes se njohurive, aftesive dhe kapaciteteve te studenteve per fushen e ketij program studimi. Sigurisht qe permiresime te tilla mbajne parasysh ngarkesen mesimore ne auditor te studenteve, sugjerojne edhe rritjen e me shume oreve praktike qofte dhe brenda syllabuseve te caktuara qe mund te kene nje numer te madh oresh. Pavaresisht se ky plan mesimor ende nuk i eshte nenshtuar permiresimeve dhe rregullimeve te mundshme, anketimet dhe testimet tek studentet jane kryer dhe vijojne te kryhen si per mesimdhenie ashtu edhe per problematika qe mund te hasin pergjate semestrit. Keto testime dhe anketime kryhen periodikisht nga Njesia e zhvillimit te Kurikules dhe Cilesise.

Departamenti eshte shprehur i gatshem te perfshije ne kete process dhe studentet dhe te terheqe mendimin e tyre konkret. Menyra e kontrollit dhe e vleresimit te dijeve eshte pjese perberese e syllabusit te cdo lende dhe ofon shperndarjen e pikeve dhe te perqindjeve te vleresimit sipas rubrikave perkatese. Qe ne fillim studenti e di se testimi final eshte 50% e vleresimit, frekuentimi eshte 10%, detyra e kursit 20% dhe testet gjate vitit jane 20%. Keto forma te vleresimit te njohurive u rekomanduan te jene standarte dhe te mos levizin nga sylabusi ne syllabus, pasi instiutcioni e ka te standartizuar kete format kontrolli ne dokumentacionin e vene ne dispozicion.

Dok 14 a Plani mesimor DMTRE

Dok 40 Pyetesori per studentet per vleresimin e modulit

Tabela me Anekse: Tab 15. Forma e kontrollit te njohurive, fq 19

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB-së dhe takimi me stafin akademik rezulton se institucioni organizon në fillim të vitit akademik “Javën e orientimit”. Gjatë kësaj jave personeli akademik i departamentit të DMTRE i njeh studentët me prgramin. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni vendos grupe pedagogesh për të informuar studentët e interesuar. Gjithashtu mbledhjet e departamentit janë të hapura për studentët e interesuar. Përgjatë javëve të regjistrimit, institucioni vendos grupe me personel akademik, për të informuar studentët e interesuar. Por pavaresisht kesaj, UniBa i ka te ngritura grupet qe merren me studentet qe ne momentin e pranimit e deri ne daljen e tyre ne pune, e kthimin e tyre ne alumni. Ato fillojne me Zyren e pranimit te studenteve, Sekretaria mesimore, Dekani i Studenteve, Zyra Alumni dhe e Karrieres, Departamenti (permes kordinatoirt, stafit dhe drejtuesit te tij).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Rolin e njësisë për këshillimin e karrierës e luan Qendra e Karrierës dhe Alumni e cila zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të UniBa. Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale apo informime ne lidhje me mundesite e punesimit te tyre. Nderkohe qe po brenda UniBa eshte ngritur edhe Klubi i Karrieres i cili perben nder klubet studentore qe organizon studentet dhe zhvillon me to aktivite lidhur me zhvillimin e tyre te karrieres. Synimi i ketij klubi eshte zhvillimi dhe permiresimi i aftesive individuale dhe profesionale te tyre, per te rritur konkurrueshmerine e tyre ne tregun e punes.</p> <p><i>Dok 12. Rregullor e zyrave ne sherbim te studenteve</i></p> <p><i>Dok 33 Tabele permbledhese per trianimet profesionale me studentet.</i></p>

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Karrieres dhe Alumni është zyra e fundit që ndjek studentet në diplomimin dhe punësimin e tyre, si dhe kthimin e studenteve në alumni efficient dhe mbështetës për këto programe studimi në veçanti, por edhe institucionin në përgjithësi. Në këtë mënyrë Bordi i Karrieres mbahet efficient dhe mbështet programin.</p> <p><i>Dok 12. Rregullore e Zyrave në Shërbim të Studenteve</i></p> <p><i>Dok 33 Tabele përmbledhëse për trajnimet profesionale me studentet</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p>Standardi VI.1</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UniBa janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Njësia e Zhvillimit të Kurikulës dhe Cilësisë (NJZHKC), Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë. Standardet për sigurimin e cilësisë në UniBa janë në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p><i>Dok.8. Rregullore e Njësies së Zhvillimit të Kurikulës dhe Cilësisë;</i></p> <p><i>Dok.13. Rregullore e komisionit të sigurimit të standardeve dhe cilësisë;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe</p>	<p>UniBa ka njësinë e zhvillimit të Kurikulës dhe cilësisë (NJZHKC) e cila ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. NJZHKC ka akses në të gjitha të dhënat e UniBa. Ai realizon politikën, strategjinë dhe</p>

<p>zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>proceset për të garantuar cilësinë në UniBa. Gjithashtu komisioni i sigurimit të cilësisë jep sygjerime dhe rekomandon në funksion të përmirësimit të cilësisë në institucion.</p> <p><i>RVB 11b. Udhëzim I UniBa, nr.61, dt. 18.02.2019-Mbledhjen e KVP.</i></p> <p><i>Dok.13. Rregullore e komisionit të sigurimit të standarteve dhe cilësisë;</i></p> <p><i>Dok.3. Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UniBa përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Instrumenti që përdor UniBa për sigurimin e cilësisë është “Manuali i Cilësisë” i cili specifikon parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në institucion në përputhje me kodin e cilësisë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit në mënyrë të vazhdueshme. NJZHKC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm duke ftuar ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë si bashkëpunëtorë të jashtëm studentët e diplomuar dhe punëdhënësit. <i>RVB</i></p> <p>Në takimin me përfaqësues të NJZHBC në UniBa dhe takimin me GVB, konkretisht, studentin që ishte pjesë e grupit të punës, u theksua realizimi dhe pjesmarrja e aktotëve të jashtëm në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka politika dhe procedura të qarta për të siguruar cilësinë të cilësisë. Struktura përgjegjëse NJZHKC, programon punën në bazë të strategjisë/manualit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, dhe planit të veprimit të përvitshëm. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, procedurat periodike që përdor për të siguruar cilësinë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i raporteve periodike të vlerësimit të brendshëm; 2. Realizimi i procesit të matjes së perceptimit të studentëve nga KVSC-ja në bashkëpunim me NJZHKC-në për cilësinë e mësimdhënies, për çdo program studimi në fund të çdo semestri; 3. Realizimi i pyetësorëve me studentët nga pedagogët e lëndës, në përfundim të çdo semestri me qëllim vlerësimin e performancës së lektorit nga ana e studentëve; 4. Hartimi dhe realizimi i analizës së punës mësimore-kërkimore në nivel departamenti dhe fakulteti;

	<p>Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësive bazë. GVJ gjatë verifikimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion konfirmon realizimin e të gjitha proceduarve periodike për vlerësimin e cilësisë</p> <p><i>Dok.8. Rregullore e Njësive të Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë;</i></p> <p><i>Dok.13. Rregullore e komisionit të sigurimit të standarteve dhe cilësisë;</i></p> <p><i>RVB</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit është sektori i kurrikulës, vlerësimi institucional dhe alumni që janë ngritur brenda NJZHKC-së dhe Zëvendësrektorit për Çështjet akademike. Në nivel njësive bazë, është Departamenti që ka programin e studimit, i cili së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve dhe përgjegjësit e grup-lëndëve është përgjegjës për sigurimin e cilësisë. <i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>UniBa përmes NJZHKC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Universiteti. Përmbajtja e këtyre raporte trajtohet në disa nivele brenda institucionit. NJZHKC nëpërmjet kontolleve të vazhdueshme të procesit mësimor, zbulon problematika të lidhura me përmbajtjen e kurrikulës dhe i referon ato departamentit për rishqyrtim. Në kuadër të objektivave të saj, NJZHKC siguron bazën e të dhënave për cilësinë e mësimdhënies. Në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, NJZHKC mbikëqyr efikasitetin e kurrikulave, pasqyrimin e tyre me korrektësi në programet lëndore, në formatin e vlerësimit të miratuar, dhe në literaturën e vënë në dispozicion të studentëve.</p>

Sopay *Sigurd*

	<p>Dok.8. Rregullore e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë;</p> <p>Dok.13. Rregullore e komisionit të sigurimit të standarteve dhe cilësisë</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>UniBa dhe struktura përgjegjëse NJZHKC përmes zbatimit të planit të veprimit të përvitshëm si dhe aktiviteteve me karakter monitorues nga Departamenti dhe njësia kryesore realizon vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit. Ajo merr në shqyrtim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrollin e vazhdueshëm të realizimit të ngarkesës lëndore dhe pasqyrimin të saj në regjistrin e pedagogut; - Monitorojnë përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të dosjeve mësimore të personelit akademik, e cila është objekt kontrolli nga NJZHKC; <p>Kontrollon zbatueshmërinë e formateve të miratuara të syllabuseve lëndore në përputhje me Udhëzimin Nr. 41, dt. 24. 01. 2018 të MASR.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Raportet e realizuara nga NJZHKC-ja janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Trajtimi i rezultateve të tyre në institucion bëhet në nivel Rektorati ku Zv. Rektori për çështjet akdemike organizon dhe mbikqyr punën e fakulteteve dhe programeve me qëllim rritjen e standarteve të cilësisë, në programet e studimit të ofruara nga UniBa dhe mësimdhënies nga ana e personelit akademik.</p> <p>Dok.8. Rregullore e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë;</p> <p>RVB</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Bazuar në RVB-në, monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të mangësive të konstatuara realizohet nga NJZHKC-ja nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme nga personat përgjegjës, autoritetet drejtuese, nga diskutimet me stafin akademik si dhe pyetësorëve.</p> <p>Në raportet e hartuara evidentohen dhe raportohen çështje si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilësia e materialeve mësimore (literaturës); - Cilësia e performancës së personelit akademik; - Komunikimi pedagog-student; - Konceptimi i transparencës në vlerësim; - Përputhja e materialit lëndor me format dhe mënyrat e vlerësimit; - Raporti teori/ praktikë në kurrikula;

	<p>Mangësit ju bëhen me dije personelit akademik të departamentit të MTRE dhe në mbledhjet e organizuara në këtë njësi ato bëhen objekt i analizës vjetore.</p> <p>Një tjetër formë është edhe sistemi i raportimit të personelit akademik në fund të çdo jave për ecurinë e procesit mësimor dhe lënë të dokumentuar komentet përkatëse lidhur me mangësitë e konstatuara. Nga takimi që GVJ pati me personelin akademik të njësisë konfirmoi jo vetëm realizimin e analizës rreth gjetjeve por edhe u njoh më konkretisht me disa prej masave që personeli akademik kishte marrë për përmirësimin e tyre siç ishte, shmangja e njohurive paralele në lëndë të përafërta, përmirësimin e formave të vlerësimit, ose shtimin e numrit të lëndëve me zgjedhje/ me karakter më praktik. <i>Vizita në Institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UniBa. NJZHKC-ja realizon vlerësim periodik në nivel institucional tek të gjitha programet e studimit. Kjo strukturë nuk harton relacione specifike në bazë programi. Departamenti realizon analizë të përgjithshme për programin e studimit Bsc “Menaxhim Turizëm, rekreacion dhe Evente”. <i>Dok.68. Vlerësimi i studentëve, Raport përmbledhës;</i> RVB</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës</p>	<p>Pas shqyrtimit të RVB-së dhe nga nga takimi më anëtarë të NJZHKC konstauam përdorimn e disa instrumetave për realizimin e procesit të vlerësimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nëpërmjet anketimit realizohet vlerësimi për çdo lëndë të çdo pedagogu nga studentët; - Përdorimi i fokus grupeve;

<p>akademike të programit të studimit.</p>	<p>- Vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit;</p> <p>GVJ konsaton se përdorimi i metodave dhe instrumenteve për vlerësim janë në përputhje me natyrën e programit të studimit MTRE në FSHTS, UniBA.</p> <p><i>Vizita në institucion; RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga takimi me përgjegjësen e departamentit dhe shqyrtimi i dokumentacionit na rezultoi se institucioni përdor forma të ndërthurura për realizimin e vlerësimit dhe ruajtjes së cilësisë së programit të studimit. Për kategorinë lektor/asistent lektor realizohen monitorime nga ana e eprorëve dhe për këtë ka një format standard ku përfshihen komponentë si organizimi dhe qartësia e leksionit; komunikimi me studentët etj. Në përfundim të procesit hartohet një raport vlerësimi mbi rezultatet e monitorimit. Format i vlerësimit të performancës akademike të studentëve bëhet nga një ndërthurje instrumentash si testim me shkrim, detyra kursi, aktivizimi etj.</p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni kryen vlerësime periodike ku për çdo semestër realizon vlerësimin me studentët përmes anketimeve; fokus grupe; takime me stafin dhe studentë etj. NJZHKC është struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit.</p> <p>Krahas detyrës që kryen NJZHKC departamenti i MTRS përdor instrumente të tërthorta vlerësimi lidhur me cilësinë e programit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komente formale dhe joformale të studentëve; - Takime me ish-studentë; - Pyetësorë; - Takime me Drejtorinë Rajonale Arsimore, Drejtues shkollash; - Sondazhe nga personeli akademik për lëndët që ata lektorojnë; <p>GVJ nga takimi me personelin akademik të njësisë që zhvillon programin MTRE konfirmoi realizimin e këtyre formave të tërthorta vlerësimi. Ata i konsideronin ato si një barometër të punës së tyre të përditëshme nga njëra anë por edhe si piketa për të vendosur prioritet në të ardhmen</p>

	<i>Vizita në institucion, Takimi me personelin akademik</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së UniBa, standardet dhe cilësia, përfshijnë disa struktura si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore-shkencore, të UNIKON-it. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të tij rregullohet me dokument të veçantë; - Komisioni Për Vlerësimin e Standarteve dhe Cilësisë - Zv. Rektor për veprimtarinë akademike; - Njësia përgjegjëse DTMR për programin e studimit Bch në MTRE; - Grupet ad hoc të vlerësimit të brendshëm; - Zyra e Burimeve Njerëzore; <p>UniBa realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë duke përfshirë disa aktorë në proces si: bordet e tregut të punës; ekspert të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si Erasmus +. Përfshirja në këto projekte ka krijuar shkëmbime përvojash, trajnime, vizita studimore si dhe procese të tjera që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e funksionit e sigurimit të cilësisë së brendshëm.</p> <p><i>Dok. 5. Rregullore Universitetit Barleti;</i></p> <p><i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat e njësive të angazhuara janë të përcaktuara në kuadrin ligjor si Rregullore e UniBa, rregullore e FSHTS, rregullore e DTMR, mbi të cilin funksionon UniBAa dhe njësitë përbërse të tij. Mbështetur në dokumentacionin mbështetës GVJ i rezulton se ekzistojnë urdhëra të rektorit dhe vendime të drejtuesit të njësisë bazë për detyra konkrete që njësitë dhe individët angazhohen në</p>

<p>ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe koordinimin e saj sektorin e projekteve, kërkimit shkencor dhe të botimeve në UniBa.</p> <p>Dok.5. Rregullore Universitetit Barleti;</p> <p>Dokumentacion shtesë. Përcillet për dijeni raporti vlerësimit të brendshëm për Bsc Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente, Universiteti Barleti</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>NJZHKC-ja nuk realizon raporte në nivel program studimi. Gjatë procesit të realizimit të pyetësorit ajo përfshin në sondazhet për vlerësim të gjithë personelin akademik, studentët e Departamentit të TMR dhe personelin ndihmës akademik. Gjithashtu, siguri i cilësisë së programit bëhet objekt analize çdo fund viti akademik nga vetë njëzia bazë që e ofron programin MTRE, nga departamenti.</p> <p>Dokumentacion shtesë. Përcillet për dijeni raporti i vlerësimit të brendshëm për Bsc Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente, Universiteti Barleti</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>UniBa ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit-NJSBC-së dhe KVSC-së (si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni ...etj). Bazuar në <i>RVB fq.83</i> përfshirja e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit të brendshëm kryet në përputhje me Kodin e Etikës dhe përpiqet të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve. RVB</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nga RVB nuk është shumë e qartë nëse ka bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe që marrin pjesë në vlerësimin e brendshëm të cilësisë. <i>Gjithashtu GVJ konstaton mungesë të dokumentacionit mbështetës lidhur me rolin që ekspertiza e jashtme duhet të japë në vlerësimin e cilësisë për programin e studimit MTRE.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të një plani veprimi vjetor të miratuar nga Rektori i Institucionit UniBA. Rregullorja e NJZHKC-së është dokumenti në të cilin përcaktohen rregullat e organizimit të veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë. Këto dokumenta sikundër pranohet në RVB dhe "...raportet e NJZHKC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë" <i>Rregullore e NJZHKC;</i> <i>RVB</i>
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato element që lidhen me këtë njësi. Në departament trajtohet me stafet akademike ato elementë të vlerësimit që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Raportet e NJZHKC-së janë transparente dhe publikohen në seksionin e Sigurimit të Cilësisë në faqen e web site-it të UniBADhe në seksionin e Vlerësimit të Performancës. GVJ hyri në këto site dhe konfirmoi publikimin e tyre. <i>RVB</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni realizon në vijueshmëri procesin e përpilimit të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Sipas RVB-së disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor. <i>RVB;</i> <i>Dok.4a. Plan Veprimi të DTMR për vitin 2020-2021;</i> <i>Dok. 4b. Plan Veprimi të DTMR për vitin 2021-2022;</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të UniBa reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej. <i>RVB;</i> <i>Dok.13a Manual i hartimit të programeve të studimit dhe ndryshimet e programeve ekzistuese.</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe	Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e NJZHKC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesit në dokumentat ku

studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. Gjatë vizitë në institucion GVJ u njoh nga personeli akademik dhe studentët që procesi i veprimtarive periodike me qëllim njohjen, ndërgjegjësimin dhe trainim është kryer edhe gjatë periudhës së pandemisë COVID 19 on-line. Duke kofirmuar edhe deklarimin në RVB të këtij argumenti. <i>RVB</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Menaxhim Turizëm, Rekreacion dhe Evente”

a. Pikat e forta dhe afirmime:


1. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies duke i bërë ata pjesë të diskutimeve në mbledhjet e departamentit duke dhënë opinionet e tyre për cilësinë e mësimdhënies;
2. Universiteti Barleti mundëson përdorimin në masë të gjerë të infrastrukturës digjitale didaktike dhe logjistike në shërbimet për personelin akademik dhe studentët, qofshin keto administrative dhe mësimore;
3. Nënshkrimi i marrëveshjeve me subjektet private mundëson zhvillimin e praktikave profesionale pranë tyre duke rritur shanset për një kualifikim profesional të studentëve krahasuar me studentët e të njëjtit profil në institucionet publike të arsimit të lartë;
4. Përshirja e studentëve në procesin e implementimit të projekteve zhvëllimore të fituara nga institucioni. Ky fakt u krijon mundësinë studentëve të zbatojnë në praktikë parimet e konceptet e marra në auditor;
5. Institucioni reflekton pjesmarrje të gjerë në projekte zhvillimore në bashkëpunim me organizata jo qeveritare në lëmin e turizmit. Me këtë institucioni realizon edhe objektivin kryesor që ka si instiucioni, atë të përfshirjes në kërkimit shkencore të aplikuuar;

b. Pika të dobta:

1. Mungesa e një studim tregu të mirëfilltë që të mbështesë ndryshime dhe përmirësime të mëtejshme të këtij programi. Studimi i tregut duhet të ketë në fokus grupet e bizneseve me të cilat njësia ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e këtij program studimi;
2. Mungesa e studimit të tregut pas diplomimit të studentëve me qëllim që të përcaktojë masën e përafrimit të diplomës së fituar me pritshmëritë e tregut të punës;
3. Mangësi në planin mesimor:
 - a. Në programin mesimor mungojnë lëndët me zgjedhje që është detyrim që rrjedhë nga VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Shpërndarja e krediteve nuk është kryer në varësi të peshës specifike që lënda ka por në mënyrë të njëtrajtshme;
 - b. Kurikula e programit MTRE dominohet nga lëndë të karakterit bazë dhe jo praktik. Problemet e identifikuar nga analiza e syllabuseve dhe planit mesimor me veprimtaritë formuese janë të tipit: probleme të emërtimit të lëndëve, të literaturës, të përmbajtjes së temave brenda syllabuseve, përplasje e temave të njëjta midis lëndëve të ndryshme, panevojshmeri e lëndëve të caktuara, si dhe riorganizimi i lëndëve sipas peshës specifike që kanë të tri disiplinat brenda programit të studimit: turizëm, rekreacion dhe evente, pra që secila prej tyre të përfaqësohet në mënyrë pothuajse të njëjtë brenda programit dhe planit mesimor;

Rekomandime:

1. Sugjerohet që departamenti që ofron këtë program studimi të ndërmarrë një studim cilësor dhe sasior të tregut, të detajuar ku të jepen të gjitha analizat, statistikat, rezultatet dhe konsiderimet e rezultuara, mbi bazën e së cilës do të mund të përmiresohet apo ndërtohet një kurrikul më cilësore e këtij programi. Në këtë mënyrë, departamenti DMTR vërtet do të realizojë një studim tregu, i cili do të mundet “të bashkë-krijojë” një kurrikul së bashku me biznesin, dhe të ofrojë atë çka kërkon biznesi, me qëllim që të rrisë jo vetëm numrin e studentëve që frekuentojnë këtë program studimi por edhe të rrisë punësimet e tyre sipas profilit të diplomës. Gjithashtu, ky program studimi ka nevojë të kryeje në mënyrë paralele edhe studime pas diplomimit të studentëve që të përcaktojë sa kanë përafruar diplomimet e tyre me pritshmëritë e tregut të punës. Pavaresisht se tregu i turizmit është treg dinamik që evoloun dhe kërkon gjithnjë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, ofrimi i një diplome cilësore do të rrisë standartin e sektorit turistik shqiptar;
2. Sugjerohet një rishpërndarje e krediteve sipas rëndësisë së lëndëve e reflektuar kjo edhe me një rishpërndarje të oreve në leksione dhe seminare. Kështu p.sh. vihet re se të gjitha lëndët kanë 6 kredite, ndërsa ka pak lëndë me të njëjtën ngarkesë orësh në leksione dhe seminare që kanë 3 kredite;
3. Trajtimi i këtij bachelori me tre kompetenca kyce: turizëm, rekreacion dhe evente kërkon pa diskutim një shpërndarje të përfuturit e marrjes së njohurive përmes 3 grupeve të lëndëve që duhet të ndahen në këto drejtime. Pra që në fillim presupohet që të ketë një “minigrupim” në




3 kategori të lëndëve: ata që japin njohuri për turizmin, ata që japin njohuri për rekreacionin, dhe ata që japin njohuri për eventet. Pasi e tillë është filozofia e ndërtimit të kësaj kurrikule, të mbulojë një fushë të gjerë të kompetencave dhe aftësive në vend të njëjës, psh manaxhim në turizëm;

4. Programi i studimit duhet të ofrojë lëndë bazë të formimit si: Manaxhimi Turizmit, Manaxhimi Turizmit të Qëndrueshem, Marketingu Turizmit, Tipologji Turizmi, Turizëm Shqiptar etj. Lëndë të tilla manaxheriale do të plotësojnë nevojën për kompetenca të qarta shkencore në fushat e turizmit, rekreacionit dhe eventeve për të cilat ka nevojë bachelor në Manaxhim Turizem, Rekreacion dhe Evente;
5. Problemet e identifikuara nga analiza e syllabuseve dhe plani mësimor me veprimtaritë formuese janë të tipit: probleme të emërtimit të lëndëve, të literatures, të përmbajtjes së temave brenda syllabuseve dhe të përplasjes së tyre midis lëndëve të ndryshme, apo panevojshmeri të lëndëve të caktuara, si dhe nje nevojë e shpërndarjes së krediteve dhe orëve sipas rëndësisë së lëndëve, si dhe e fundit e riorganizimit të lëndëve sipas peshës specifike që kanë të tri disiplinat brenda programit të studimit: turizëm, rekreacion dhe evente, pra që secila prej tyre të përfaqesohet në mënyrë pothuajse të njëjtë brenda programit dhe planit mësimor;
6. Të rritet financimi nga institucioni për pasurimin e bibliotekës me botime të viteve të fundit nga autorë vendas dhe të huaj në fushën e turizmit. Rekreacionit dhe eventeve;
7. Të hartohet një rregullore e dedikuar për zhvillimin e provimit përfundimtar dhe për mbrojtjen e diplomës. Në to të detajohen të drejta dhe detyrimet e njësisë që mbulon programin, studentëve dhe personeli akademik në kryerjen e këtij procesi;

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program "Tourism, Recreation and Event Management"

a. Strengths and Affirmations:

1. The institution guarantees the involvement of students in the periodic evaluation of teaching methods by making them part of the discussions at departmental meetings, giving their opinions on the quality of teaching;
2. University of "Marlin Barleti" enables the widespread use of digital didactic and logistical infrastructure in services for academic staff and students, both administrative and teaching;
3. The signing of agreements with private entities enables the development of professional practices with them, increasing the chances for a professional qualification of students compared to students of the same profile in public institutions of higher education;
4. Involvement of students in the process of implementation of development projects acquired by the institution. This fact creates the opportunity for students to put into practice the principles and concepts learned in the classroom;




5. The institution reflects extensive participation in development projects in cooperation with non-governmental organizations in the field of tourism. With this, the institution realizes its main objective as an institution, that of involvement in applied scientific research;

b. Weak points:

1. Lack of a genuine study of the labor market to support changes and further improvements of this program. There should be a market study in the focus groups of the businesses with which the unit has signed cooperation agreements for the development of this study program;
2. The lack of market study after the graduation of the students in order to determine the degree of approximation of the degree obtained with the expectations of the labor market;
3. Absence in the curriculum:
 - a. The curriculum lacks optional subjects, which is an obligation stemming from Decision of the Council of Ministers No. 41, dated 24.01.2018. The distribution of credits is not carried out depending on the specific weight that the subject has, but uniformly;
 - b. The curriculum of the MTRE program is dominated by subjects of a basic and non-practical character. The problems identified by the analysis of the syllabuses and the educational plan with formative activities are of the following types: problems of naming the subjects, of the literature, of the content of the subjects within the syllabuses, collision of the same subjects between different subjects, the unnecessariness of certain subjects, such as and the reorganization of subjects according to the specific weight that the three disciplines have within the study program: tourism, recreation and events, so that each of them is represented in almost the same way within the program and curriculum;


Recommendations:

1. The external evaluation group suggests that the department that offers this study program undertake a qualitative and quantitative study of the market, detailed where all the analyses, statistics, results and resulting considerations are given, on the basis of which it will be able to improve or build a quality curriculum of this program. In this way, the DMTR department will really carry out a market study, which will be able to "co-create" a curriculum together with the business, and offer what the business requires, with the aim of increasing not only the number of students who attend this study program but also to increase their employment according to the degree profile. Also, this study program needs to be carried out in a parallel way and studies after the graduation of the students to determine how their graduations have aligned with the expectations of the labor market. Regardless of the fact that the tourism market is a dynamic market that evolves and always seeks to improve the quality of services, offering a quality diploma will raise the standard of the Albanian tourism sector;
2. The external evaluation group suggests a redistribution of credits according to the importance of the subjects, reflected by a redistribution of hours in lectures and seminars. Thus, for



example it is noted that all subjects have 6 credits, while there are few subjects with the same load of hours in lectures and seminars that have 3 credits;

3. For the realization of the three key competencies: tourism, recreation and events in this study program, an equal redistribution of the amount of knowledge gain is suggested between these 3 groups of subjects, those who provide knowledge about tourism, knowledge about recreation, knowledge about events;
4. The study program should offer basic training subjects such as: Tourism Management, Sustainable Tourism Management, Tourism Marketing, Tourism Typology, Albanian Tourism, etc. Such managerial subjects will fulfill the need for clear scientific competencies in the fields of tourism, recreation and events for which a bachelor's degree in Tourism, Recreation and Event Management is needed;
5. To revise the syllabuses of the subjects and to fill the identified deficiencies such as: the placement of practice in the curriculum, problems of naming the subjects, of the literature, of the content of the topics within the syllabuses and their collision between different subjects, or the necessity of certain subjects, as well as a need to distribute credits and hours according to the importance of the subjects, as well as the last reorganization of the subjects according to the specific weight that the three disciplines have within the study program: tourism, recreation and events;
6. To increase funding from the institution for enriching the library with publications from recent years by local and foreign authors in the field of tourism. Recreation and events;
7. To draw up a regulation dedicated to the conduct of the final exam and the defense of the diploma. They should detail the rights and obligations of the unit that covers the program, students and academic staff in carrying out this process;

Two handwritten signatures in blue ink are present at the bottom of the page. The signature on the left is highly stylized and appears to be 'Lepim'. The signature on the right is also stylized and appears to be 'C. C. C.'

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X